



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master në Arte, “Pikturë Monumentale dhe Mësuesi”
Institucioni i Arsimit të Lartë: Universiteti i Arteve, “Fakulteti Arte të Bukura”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Mariana Sinani, Prof.As

2. Zeni Ballazhi, Prof.As

Mars 2023

Më datën 22.02.2023 përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr prot 52/6 dërgohet në institucion DRVJ. IAL Përcolli komentet përmes AMS date 07.03.2023 dhe me shkresë zyrtare nr prot 229/1 date 10.03.2023.

Rreth përgjigjes zyrtare të IAL, {UART}, FAB, në raport me RVJ

Grupi i ekspertëve RVB

E gjejmë të arsyeshëm reagimin dhe arsyetimin e Grupit RVB, sa i përket sygjërimeve që kanë përcjellë ekspertet e jashtëm, të lart përmendur. Ashtu sic dhe është përshkruar përgjatë raportit, nënvizojmë se programi

1. Pikturë Monumentale dhe Mësuesi

Konsiderohen nga ana jonë: të qartë, të strukturuar, dhe konform frymës së ligjit.

Sa i përket pikave {a, b, c, d}, IAL, FAB dhe Ekspertet e RVB, janë të lejuar të mos i zbatojnë, pasi secila nga pikat në substancën e tyre, {a, b, c, d}, nuk e prek thelbin e programit.

Në respekt të fushës të cilën e përfaqësojnë të cilat janë: fushat e edukimit dhe në respekt të faktit që në këtë program do të diplomohen studentë në fushat e mësuesisë, priremi që nga tërësia e ECTC...të kemi disa ECTS më shumë që fuqizojnë të qenët Mësues, {në rastin konkret do sygjeronim të kemi plus...deri në 3 ECTS}. Kjo kërkesë mbetet në fuqinë tuaj për të mos e përmbushur...Porë nga ne:

Ky sygjërim do fuqizonte disi më shumë "Etikën dhe Komunikimin" si dimension mësimdhënës dhe si dimension artistik. Institucioni juaj e ka përfshirë "Kodin Etik", Por në këndshikimin tim/tonin, "Etika dhe Komunikimi" është një fushë më e gjërë studimi, dhe merr peshën specifike të një discipline të mirëfilltë, pasi pikëpëriten disa disiplina dhe-koncepte. Kjo do pëfshijë dhe Etikën si shkenca e komunikimit, dhe Kodin Etik, si tërësi rregullash që funksionojnë brenda një profesioni, dhe teorite të komunikimit në grupmosha heterogjene dhe homogjene njëkohësisht, sic është "klasa" si institucion brenda institucionit shkollë. Mësuesia si profesionin i rregulluar, e ka të nevojshme dijen për rregulloren e brendshme të institucionit shkollë...kodin e etikës brenda këtij profesioni, komunikimin si gjuhë dhe normë etike, aq i rëndësishëm për tu cekur nga studentët që pritet të marrin Diplomën e mësuesisë}. Gjithësesi, jeni të lire të ruani emërtimin "Kod Etike", por, I quajtur kështu, i "rrin ngushtë" Etikës dhe Komunikimit si dy shkenca derivate të njëra tjetres...

Gjej rast të jem mirënjohëse që:

1. *Keni pranuar sygjërimin për të ri-shikuar në bllokun {A} mundësinë brenda disiplinave pa prekur strukturën. I referohem arsyesimit dhe {shenimit tuaj si vijon}: Mendojmë se sygjërimet tuaja për lëndët e mësuesisë, referuar modulit {A} së pari janë të drejta, dhe do t'u sygjërohet pedagogëve të lëndëve përkatëse për të rregulluar raportet e*

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


shperndarjes se oreve në temat që sygjeroni brenda oreve aktuale të shënuara në Planin mësimor} ...shih fq.7

2. Pikën d. Sa i përket qartësimin të termit "laborator". Grupi RVB, ka mirëpritur sygjerimin që vjen nga ekspertet e RVJ, dhe ka pranuar nevojën për tu ndalur sa herë lipset të operohet me këtë term "laborator" kur është fjala për të operuar në fushat e artit dhe të mësimdijës. Kanë pranuar nevojën për të mbajtur brenda kontekstit termin "Laborator" dhe për të bërë difertencën me termin "Atelier".

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al





RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master në Arteve, “Pikturë Monumentale dhe Mësuesi”
Program i Integruar i Nivelit të Dytë ofruar nga Fakulteti “Arte të Bukura”
Universitetit Artev”

Nr.		
1	IAL aplikues:	UART
2	Njësia bazë që e ofron:	FAB...Departamenti i Pikturës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Programi në Cikli i Dytë. “Pikturë Monumentale dhe Mësuesi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Nr. 821. Date 26.12.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Cikli i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	Dy vite akademike, kater semestra,
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ETC
11	Forma e studimit:	Kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Programi ofrohet nga FAB ne bashkepunime brenda UART dhe permes marrveshjeve Zyrtare te institucionit
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Diploma lëshohet nga FAB dhe është e regjistruar konform Ligjit
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli – 7 në kornizen e kualifikimit
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10 pedagogë të brenshëm me tituj dhe grada dhe 3 pedagogë të jashtëm me tituj dhe grada
18	Numri i studentëve:	
19	Komente / të tjera:	Komentet janë ofruar përgjatë RVJ

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës:

Programi Master në Arte në fushën “Pikturë Monumentale dhe Mësuesi” është inicuar nga Departamenti i Pikturës në Fakultetin Arte të Bukura në Universitetin e Arteve, {UART}. Ky Program vjen i riorganizuar në frymën e vendimit me Urdhër të MASR nr. 821 datë. 26.12 2018, “Për Riorganizimin e Programeve të studimit të Ciklit të Dytë në UART. Programi në fjalë, përmbushet në Fakultetin e Arteve të Bukura në Departamentin e Pikturës, në hapësirën kohore dy vite akademike. Cdo vit akademik, Programi është i përthyer në syllabuse, të cilat të përkthyer në gjuhën e krediteve janë 60 ECTS në një vit akademik, që në dy vite rezulton të jetë 120 ETC.

Programi “Pikturë Monumentale dhe Mësuesi” përmbush qëllimin dhe objektivat e veta në frymën e strategjise, rregulloreve dhe parimeve të IAL, domethene te UART. Ky institucion është unik. Daton me një profil të spikatur prej themelimit të tij në dt.15 janar 1966. Unikaliteti i institucionit lidhet jo vetëm me historinë e tij të shtrirë në kohë, por dhe me faktin se, është Institucioni me profil, formimin artistic dhe akademik njëherësh në Republikën e Shqipërisë. Programi e përmbush qëllimin dhe objektivat e veta nën drejtimin direkt të Departamentit të Pikturës dhe Fakultetit të Arteve të Bukura si dhe institucioneve dhe instrumenteve legale brenda Universitetit të Arteve, UART. {Shih RVB, fq.1,}

Formatimi i programit në fjalë, ka ndjekur procedurat ligjore, administrative, akademike në përputhje me detyrimin ligjor. {shiko, Evidencë 9. Fq.12} Procedura për formatimin e programit në fjalë i referohet Ligjit nr.8/2015 neni nr. 71, për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë. Diploma dhe formati i Programit, dhe tërësia e koncepteve me të cilat operon Programi në fjalë, i referohen dhe e përmbushin në mënyrë adeguate konceptet: lëndë bazë, lëndë integruese, lëndë me zgjedhje, praktikë mësimore, grup-lëndor, kopetence profesionale, modul, syllabus, laborator, e tjer. {Shiko Evidencë 11, fq. 1,2} Programi shtrihet në dy vite akademike në katër semestra dhe përkthehet në 120 ECTS referuar sistemit të Bolonjës. Programi është i transferueshëm. Programi përmbush kushtet për te qene në sistemin e Profesioneve të rregulluara, pra, profesionin e mësuesisë. Programi është i transferueshem.


PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm: Prof.As.Dr. Mariana Sinani dhe Prof.As.Dr. Zeni Ballazhi u angazhuan në cilësimin e ekspertëve të jashtëm respektivisht në dy fusha të dijes me theks: Artin në Pikturën Monumentale, nga njëra anë, dhe dijen Metodologjike, Psiko-Pedagogjike e Didaktike nga ana tjetër. GVJ u angazhua në përgjigje të kërkesës së IAL, Universitetit të Arteve, Fakultetit të Arteve të Bukura, Departamentit Pikturë, dhe me vendim të ASCA u ndërmor dhe u realizua RVJ.

Ky proces vlerësimi u përbush nga ekspertët në praninë e specialistit të ASCAL, Znj Anilda Beqiraj. GVJ, mori në analizë kurrikulën e programit, kohështirjen, instrumentet e përbushjes së programit, profilin e studentëve që përgatiten në këtë program, syllabuset, përthyerjen e tyre në ECTS, praktikat mësimore e praktikat profesionale, instrumentet e vlerësimit të studentëve përgjatë programit, performancën e stafit akademik e profesional, mjediset fizike ku përbushet programi, politikat e zhvillimit profesional të stafit, e tjer. Ekspertët e jashtëm ju referuan detyrimit që të bëjnë vështrime analitike, qasje faktike të situatës, treguesit e matshëm dhe vlerësimin sipas standardeve për kategoritë e përcaktuara në udhëzuesin e vlerësimit të jashtëm.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm punoi në datat 14,15,16, dhjetor, 2022, referuar Agjendës së IAL të konfirmuar nga dy institucionet respektive. U organizuan biseda të qëllimta me drejtues të Institucionit, stafin akademik, studentët, sekretarinë mësimore, Zyrën e Burimeve Njerëzore, si dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Koordinimit dhe mbështetjes ndaj Studentëve, Zyren e Burimeve njerëzore, Sekretarinë e institucionit. U selektua në mënyrë të qëllimtë informacion dhe u hoqën paralele mes asaj që "gojarisht" stafet e përfshira artikuluan, dhe dokumentacioni që e dokumentonte referuar RVB. Gjatë vizitës në institucion u kryen vizita të qëllimta studimore në mjediset e bibliotekës, ateljereve, si dhe në hapësirat fizike ku përbushet programi në fjalë. Gjatë vizitës u asistua në orë mësimi ku deshmojmë performancën mësimdhënëse dhe mësimnxënëse.

RVJ është projektuar dhe realizuar në respekt të: 1.vizitës në Institucion si dhe në 2. respekt të RVB, saktësisht referencat janë marrë nga Evidencat e listuara nga IAL, si dhe në respekt të mesazheve nga bashkebisedimi i qëllimtë përgjatë vizitës në institucion në datat respektive.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në “Pikturë Monumentale dhe Mësuesi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Gjatë vizitës së zhvilluar në Institucion, si dhe nga leximi me lupë, i RVB, e konfirmojmë se Programi në fjalë që synon të diplomojë studentë në fushën Pikturë Monumentale në Mësuesi, është në rezonancë të plotë me strategjinë e institucionit, interesat kombëtare, nevojat e tregut në sistemin e arsimit parauniversitar dhe rreket të përmbushë qëllimshëm këto interesa në nivelin akademik, kulturor, edukativ, shkollor, në sinergji me konstitucionin shpirtëror shqiptar dhe atë kontemporan. {Shih, Evidencë 33. Analizë tregu} Evidencë 1.Riorganizimi i programeve te Ciklit të Dytë, evidencë 2}Evidencë 8, Statuti UART, Evidencë 11, RRegullorja e Programit
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	E konfirmojmë që Programi i studimit në fjalë, është hartuar dhe përmbushet në përputhje me frymën e institucionit, si institucion kombëtar i konfirmuar për cilësinë e spikatur në disiplinat e artit, dijes artistike, edukimit, mësimdhënjes, transmetimit, dhe kërkimit shkencor në fushat e artit dhe dijes shkollore në arte. {shih Evidenca 12,13. Rr. Mësimore, Plani strategjik i institucionit,}
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.	PO. Programi rezulton të jetë hartuar në përputhje me strategjinë afatgjatë të UART, Statutit, Rregullores/rregudhoreve, mbi të cilat IAL funksionon si dhe në rezonance me frymen e ligjit për arsimin e lartë. Statusi i vecantë që mori Universiteti i Arteve me Vendimin nr.145, dt.10.03.2021, krijoi hapësira të reja IAL duke ridimensionuar këtë institucion në funksione te reja jo vetëm artistike, por, akademike, kërkimore, educative, mësimdhënëse, menaxheriale. {Shih, Evidencë 11, rr. Programit, Evidencë 8, Statuti i Institucionit}
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet	Vizita në IAL, na e konfirmoi që ajo cka ishte shkruar në RVB ishte e vertëte, pertej asaj që pritshmeria jonë si ekspertë ishte të ngrinim “pikëpyetje” të arsyeshme për të hetuar në cilësinë e programit në aspektin metodologjik e shkollor. Interesat kombëtare pikëpriteshin me prirjet rajonale, globale, dhe referencat ishin njëherësh kombëtare, rajonale,

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	europiane, kontemporane, vetë-zhvilluese dhe konkurruese. Kjo gjendet e shprehur qarte, dhe në dokumentet e formuluar nga IAL si Statuti dhe rregulloret e institucionit, por dhe artikullohet në të gjitha bashkëbisedat e realizuara në vizitën në institucion.		
	{Shih, Statuti i UART, dt.07.07. 2021}		
Konkluzione	Konfirmojmë se Standarti I.1 është i përmbushur plotësisht		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi 1.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Gjatë vizitës në IAL, bashkëbisedave me stafin, studentët, drejtuesit, si dhe zyrat që projektojnë politikën rreth programeve, konstatuam se egziston mjaftueshëm ekspertizë dhe vetëdije profesionale me kahe nga profesioni i mësuesisë, jo vetëm në rrafshin e profesionit si pikturë monumentale, përvojë dhe angazhim qoftë nga stafi mësimor, akademik, qoftë nga stafi mbështetës, që garantojnë përmbushjen e programit në fjalë. Evidencë- {bashkëbisedat me stafin akademik dhe studentët}
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Duke verejtur me kujdesin e nevojshëm besoj dhe të mjaftueshëm, konstatuam se: fusha e përgjithshme e studimit dhe ajo specifike ishin në coherencë mes tyre. Fushat ndihmonin dhe ushqenin njëra-tjetren. Piktura Monumentale dhe Mesuesia potencialisht dhe realisht bashkeveprojnë në këtë program. Ka mjaftueshëm pikëprerje mes tyre. Ato përcjellin komunikimin, dhe mesazhet e kërkuara qoftë në një mjedis specifik që mundet dhe pritet të jete "klasa" si koncept në mësimnxënje, qoftë në një hapësirë më heterogjene që mund të jete një ekspozite, me public hetoregjen...Thene e theksuar, programi potencon njëkohësisht një mësues dhe një mësimdhënës me dijen si Pikturë në fushën e monumentales. Programi konvergjon me frymen evropiane të kurrikulave që ofrojnë programe crosskurrikulare. Programi në fjalë, ka të trashëguar dhe konsoliduar mësimdhënjen si process universal pasi praktika mësimore në të bërit "pikturë monumentale" ...kalon përmes proceseve dhe dilemave vete-zhvilluese, Psiko-Didaktike dhe transferon komunikimin e nevojshëm të pikturës monumentale si formë e edukimit dhe si gjuhë artistike.
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me	E konfirmojmë se Programi në fjalë, jetëzon veprimtarinë e tij brenda "habitatit" të natyrshe, duke qëne se jetëzohet në fakultetin e Arteve të Bukura. Ky program ka avantazhin të jete mjaftueshëm i ushqyer në dijen

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	akademike që vjen nga stafi, bashkuar me përvojën e konfirmuar të IAL nder vite, cka në kënd vështrimi tone, ky program konsiderohet paraprakisht me mjaft shanse për të diplomuar mësues në arsimin parauniversitar. Nderdisiplina dhe dija e integruar është në natyrën e dijes që përcjell të bërit pikturë Monumentale.						
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	E konfirmojmë se Programi në fjalë funksionon në “habitat” e vet. Per këtë arsye dhe të tjera, programi ka mjaftueshëm potencial të vetë zhvillohet natyrshëm brenda fuqisë që prodhon vetë Institucioni. Komponentin që lidhet me shkencat që të bejnë mësues, e ka relativisht mjaftueshëm të zhvilluar vetë Institucioni. Kjo do kuptuar se Diplomimi jo vetem si piktur por, edhe, si Mësues në Pikturë monumentale, është potencialisht dhe realisht i pranishëm në programin në fjalë. {Evidenca 26, praktika mësimore i mundur}.						
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	IAL, Potencialisht ofron trajnime profesionale në fushën e Pikturës Monumentale, por, kjo nuk u konstatua të ishte pjesë e politikave të Institucionit dhe as të konsiderohej si burim për rritjen e të ardhurave në IAL.						
Konkluzione	Konfirmojmë se: Programi në fjalë ka përputhje të dijes akademike specifike {pikturës Monumentale} dhe dijes Psiko-Pedagogjike e Didaktike. Kjo konfirmohet nga RVB ku grup lëndët i konsiderojmë në raport relativisht të drejtë mes dijes që të ofron programi për tu diplomuar si Mësues dhe dijes që ky program ofron në thellimin e dijes karakterizuese, të bërit Piktur në Monumentale. {Shih Evidencë 22, Plani mësimor}						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe	Dukshëm u konstatua që kishte bashkërendim të institucioneve brenda IAL në funksion të përmbushjes së qëllimit të programit. Konstatuam ndarje adeqate të detyrave referuar strukturave në institucion dhe koherencë në cdo veprim të strukturave. Secila structure njëjthe sa dhe si struktura tjetër bënte çfarë dhe si...! Ndarja e detyrave dhe përgjegjësia e secilës structure ishte konform ligjit, në përmbushje të rregullores/ve të brendshme. Veprimtaria e strukturave ndiqte logjikën e rregullave që garantojnë cilësinë e programit. Rregullorja e Programit derivonte nga rregullorja e Departementit, kjo e fundit derivonte nga rregullorja e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Fakultetit, gje që të con të besosh në coherencën e proceseve, por jo vetëm, por dhe koherencë në procedura dhe vendimmarrjet që garantojnë cilësinë e programit. {Shih, Evidenca 11 dhe 33, rregullorja mësimore, rregullorja e programit.								
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Objektivat mësimorë të programit në fjalë ishin product i convergimit të dijes akademike referuar lëndëve karakterizuese dhe dijes në shkencat e edukimit, dijes që të ndihmon të formohesh si mësues në diet artistike. Referuar faktit që pedagogët ne Pikturë Monumentale, kanë përcjelle dijen tek studentët ndër vite... priremi të besojmë se potencialisht stafi është njëherësh edhe “mësimdhënes”... Statusi i ri i IAL, stimuloi marrveshje dhe memorandume brenda dhe jashte vendit, gjë që pritet ti rrise mundësite për krahasim, konkurrencë, konfirmim të këtij programi edhe në dijen shkollore. {Shih, Evidenca 16,17,18, Marrveshjet ne funksion te Programit}								
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Permbushja e objektivave akademikë dhe objektivave specifike mësimdhënës dhe educative të programit është parë dhe në aspektin e raporteve ekstra institucionale. IAL, ka sinergji me institucione të nivelit të lartë artistic si Institucione kombëtare TOB, Teatri Kombëtar, Teatrot e tjera, shkolla të edukimit Artistik më profil të konfirmuar kombëtar me të cilat ka raporte retrospective dhe perspective. Programi ka garantuar përmbushjen e praktikave mësimore në kuader të diplomimit “Mësues” përmes marrveshjeve me DAR. Marrveshjet në dimension akademik janë më të theksuara në rastet kur Programi përfiton falë marrveshjeve që potencon Zyra e Projekteve si: Programi, Erasmus, Erasmus + Programi Hipa, Jouth Tirana Capital, e tjer. {Shih Evidenca 25, marrëveshjet në kuader të programit}								
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Njësia përgjegjëse për programin në fjalë harton dhe dokumenton raporte periodike të cilat dokumentohen dhe bëhen të ditura për të interesuarit në sistemin e brendshëm në IAL, rreth ecurisë dhe përfitimeve nga marrveshjet të projekteve që potencojnë direct programin. Shih Evidencë 11, rregullorja e programit}								
Konkluzione	Konfirmojmë që Standarti I.3 është i përmbushur								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi në fjalë ka një strukturë conform ligjit në fuqi, dhe në përputhje me sistemin European, Kartën e Bolonjës. Programi shtrihet në hapësirë kohore akademike dy vite akademike. Programi është i organizuar në veprimtari shumë dimensionale: Akademike, veprimtari ku aplikohet dija e përthyer në vepër/a artistike, të cilat mund të jene dhe të përmbushen në rrafshin individual, apo në grup, për këtë, studentët ushtrohen në rrafshin e leximit, përthypjes se dijes artistike dhe njëkohësisht dijes shkollore, në auditore, si dhe ushtrohen në atelje specifike dhe mjediset ku konfirmohet performance në dizejtimet dhe skicimet në telajo... dhe performance, personale apo në grup. Programi në fjalë që pritet të diplomojë “Mësues” ka në masën relativisht te nevojshme dijen Psiko-Pedagogjike dhe Didaktike. Kjo dije {artistike dhe mësimdhënëse} është e përthyer në 120 - ECTS, referuar normës europiane. Ku një orë mësimore përthyeret në 50 min. <u>Studenti merr informacionin e mjaftueshëm për detyrimet gjatë përmbusjes në program deri në procesin përfundimtar, Diplomim.</u> Gjithcka është e shkruar qarte në Rregulloren Mësimore të Masterit në Fjalë dhe është e vulosur nga Senati.</p> <p>{Shih evidencë 9, Statuti i UARS dhe Evidencë 11, Rregullore e Programit}</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë</p>	<p>PO. Programi në fjalë, ofron dijen akademike në fushën e Artit të Pikturës Monumentale dhe “Mësuesi”. Njëherësh Programi garanton në terma të matshëm dhe të vlerësueshëm performancën artistike individuale dhe atë në grup, si dhe performance në fushën e dijes didaktikë e rreth- shkollore. Teorite, që lidhen me fushat respective, tradita, bashke coherenca rajonale, europiane, kopetenca artistike, kopetenca komunikuese, kopetenca transmetuese përcjellëse e arteve në pikturë, shfaqen si objektiva të sofistikuar në programin në fjalë, por teresia e dijes akademike, kopetencës artistike, kopetencës mësimdhënëse janë të legalizuara në Rregulloren e Departamentit dhe detyrimet të studentit. {Shih Evidencë 12}. Ajo që fuqizon dhe potencon shprehitë e studentit janë mjediset atelje, oret e praktikës mësimore dhe asaj artistike si dhe praktikës profesionale.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

të specializuar studimi ose profesionale.	
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi ka të përthyer qëllimin e objektivat e veta në currikulën, syllabuset, orët e ateljerit, orët në funksion të praktikës mësimore, të cilat janë të përthyer në orë mësimore, dhe në ECTS, referuar sistemit europian. Programi ka qartësisht të theksuara orët e praktikës mësimore {150 ore} Orët e projektit artistic {260 orë} {Shih Evidencën 30, Plani mësimor}
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.	Programi në fjalë, pritet të diplomojë qëllimshëm, Mësues në Artin "Pikturë Monumentale dhe në Mësuesi". Ky program është i pari i këtij lloji në sistemin tone të lartë arsimor, product i politikave të Universitetit të Arteve, dhe të një hulumtimi empiric dhe një kërkimi me instrumente në "terren" pse dhe si mund të përmbushet dija artistike në sistemin e arsimit parauniversitar publik... {Shih Evidenca 9, dhe Evidenca 33, Statuti dhe rregullorja e IAL, Misioni- Vizioni}
Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të currikulës me përmbajtje të ngjashme.	Programi në fjalë është i shtrirë në dy vite akademike, ngrihet mbi programin Bachelor në Pikturë që ofrohet në FAB, dhe ka 120 ECTS. Programi në fjalë ofron relativisht mjaftueshëm disiplinat të shkencave të edukimit që e potenciojnë studentin të bëhet e të ushtrorë dhe profesionin e Mësuesisë. Disiplina si: Psikologji zhvillimi në aspektin e artit, teoritë e të nëxënit, menaxhim i mësimin, zhvillim i currikulës, vlerësim i nxënësit, metodologji të mësimdhënjes, shkrimi akademik...e dëshmojnë angazhimin e programit në dimensionin e të qenit potencialisht dhe realisht Mësues. {Shih- Evidencë 22} Por, referuar skemës ku janë paraqitur disiplinat në: Modulin A. ka në dispozicion 15%-20% ECTS, ku parashihen lëndët: Metodologji mësimdhënjeje, Teoritë e të nëxënit, Vlerësimi në arsim, Zhvillim Currikulës, Psikologji zhvillimi, i gjithë Moduli A. Lëndët bazë marrin deri në 20 ETC, ndërkohë që . Modulin B, pra, Lëndët karakterizuese. Pikturë murale, Pikturë transparente, Teknologji, marrin 50% - 55%, deri në 50 ECTS. Modulin C. Lëndët ndërcurrikularë, Njohuri Arkitekture, Histori Arti, Estetike, Fotografi, Njohuri kompjuteri H-3, Shkrim Akademik, Menaxhim Arti, marrin 12%-15% të programit. Modulin D. Praktikë mësimore, Aftësim në Informacion, Laborator, marrin 10%-15% të programit. Diploma merr 20 ECTS. Sygjerojmë që: . Referuar detyrimit që ka programi për të diplomuar Mësues, mendojmë se ka hapësirë për të ri-parë raportin midis modulit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>A dhe Moduli B dhe... ka mundësi për të ri-parë raportet midis Moduli C dhe moduli D. Sygjerohet të shikohet mundësia për të dhënë shtese minimalisht 5 ECTS moduli A. Moduli D, në këndvështrimin tonë vjen disi paqarhtë, pasi "Laboratori" nuk konsiderohet Lëndë në konceptin universal të "lëndës". Laboratori është në funksion të një disipline të caktuar dhe bashkëjeton me disipinën dhe vihet në funksion të përmbushjes së saj.</p> <p>Duke rishikuar me kujdes konceptin "Menaxhim" në Art dhe Menaxhim të klasës, sygjerohet të shihet mundësia për të lënë hapsire disi më shumë, menaxhimit të klasës. Etika dhe Komunikimi si dimension ku pikëpëritet dhe profesioni i Mësuesit dhe Profili i Artisti, i duhet gjetur hapësire brenda Programit kësaj disipline {qoftë dhe në 3 ECTS}. Studentët lipset të marrin minimalisht njohuri rreth faktit që Mësuesia është profesion i rregulluar dhe si i tillë, MAS, ka formuluar prej vitesh një "Kod Etike" që rregullon mardhëniet në jetën e shkollës.</p> <p>{Shih Evidence 30, Plani mësimor} {Referuar RVB rezultojnë të jene të dhëna të ndryshme...?}</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Programi në fjalë është i organizuar teorikisht dhe njëherësh përmbushet referuar ligjit për arsimin e lartë në republikën e Shqipërisë, dhe njëherësh referuar specifikës respective që përcaktohet nga detyrimi për tu formuar si Mësues në artin e Pikturës Monumentale. Studentët që furnizojnë këtë program janë kryesisht nga Bachelor në artet respective dhe pjesa tjetër vjen nga trojet shqiptare që kanë kryer studime thuajse në fusha të përafërta.</p> <p>{Shih - Evidencat e sekretarisë dhe dosjet personale të studentëve}</p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>E konfirmojmë se Programi në fjalë që angazhohet të diplomojë Mësues në Pikturë Monumentale, është i ngjashëm në masë 70% me mastera në fusha të tjera të cilët angazhohen të diplomojnë Mësues. Ky program ofron përmes currikulës së tij, disiplina bazale që të bëjnë mësues, si dhe ofron praktikën mësimore që konsiderohet factor esencial për tu diplomuar si Mësues.</p> <p>{Shih- Evidence 26, Rregullorja e Praktikës mësimore}, Por sygjerohet</p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi në fjalë i është nënshtruar procesit të Kodifikimit, referuar ligjit të arsimit të lartë.</p> <p>Grup-lëndët, janë të organizuara në blloqet:</p> <p>a. Disiplina bazë, b. Disiplina karakterizuese, c. Disiplina ndërcurrikulare, d. Lëndët me zgjellje, e. Praktika mësimore, si dhe bashkëngjitur, Sistemi i vlerësimit, Projekti artistic, dhe Tema e Diplomës. Të gjitha janë të përthyerë në orë dhe ECTS.</p> <p>{Shih- Evidencë 11, 33}</p>

Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi në fjalë nuk është product i përbashkët me ndonjë institucion tjetër. Programi është product eksklusiv i FAB dhe UART. Por, programi në fjalë priret të pasurohet përgjatë përbushjes së objektivave që aktualisht, janë të mirë formuluar në syllabuse dhe në të gjithë materialet që janë bashkëngjitur me Programin.		
Konkluzione	Konfirmojmë Standartin përgjithësisht të përbushur. Sygjerojmë të merret në konsideratë Kriteri 6 i këtij Standarti.		
Shkalla e përmbyshjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Fërbushet plotësisht
			X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Konfirmojmë që: Njësia përgjegjëse për programin në fjalë, ka angazhim periodic, për strukturën akademike, stafin që përbush programin, afatet, instrumentet e vlerësimit të studentëve, instrumentet e vlerësimit periodic të stafit, praktikat profesionale, praktikat mësimore, informon strukturat vendimarrëse brenda IAL për ecurinë e programit, informon studentët për raportet e përgatitura, dokumenton të gjithë procesin e përbushjes së programit, dhe organizon procesin e RVB për të kërkuar RVJ, referuar instrumenteve zyrtare të RVB dhe referuar detyrimit ligjor për tju nënshtruar ligjërisht RVJ dhe definitivisht akreditimit. {Shih - Evidencë 1}
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	E konfirmojmë që: NJSBC funksionon si një organizëm dhe ka dijeni të detajuar për gjithëcka që lidhet me përbushjen e programit. Kjo structure e përbush detyrën në përputhje me funksionet që i jep ligji në fuqi, si dhe Statuti dhe rregullorja e Programit. Kjo strukturë është llogaridhënëse në strukturat brenda IAL dhe kërkon periodikisht dhe qëllimshëm përbushjen cilësisht të programit. NJSBC garanton asistimin e stafit akademik, mbështetës, mësimor, e tjer përgjatë gjithë kohe-shtrirjes së programit deri në diplomimin e studentëve.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinitorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	E konfirmojmë që programi kishte kordinatorin, si person profesionalisht dhe juridikisht përgjegjës për dokumentimin dhe ecurinë e detajuar të programit përfshirë dhe praktikave mësimore. Statusi i kordinatorit të programit është i konfirmuar në dokumentacionin bazë të FAB dhe operon me statusin që IAL i nje personit, në këtë detyrim ligjor. Shih Rregulloren e programit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Konkluzione	Konfirmojmë Standartin relativisht te përmbushur		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.3
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Po. E konfirmojmë që Njësia përgjegjëse për Programin në fjalë disponon informacionin e nevojshëm rreth structures, përmbajtjes së programit, procedurave të përmbushjes, stafit akademik dhe stafit lehtësues, mjediseve fizike ku përmbushet programi, e tjer.. Kjo u konfirmua përgjatë vizitës në Institucion, ku morem përgjigje për cdo pyetje që u adresua te NJSBC.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Po. Konfirmojmë që Plani Mësimor është i strukturuar në formatin që kërkon ligji: Organizimi në disiplina bazë, disiplina karakterizuese, disiplina nderkurrikulare, disiplina me zgjellje, praktikën mësimore, projektin artistic, temën e diplomës. Plani është i përthyer në semestra, në javë mësimore, ore mësimore, dhe i përkthyer në ECTS. Plani mësimor është i detajuar sipas një skeme ku paraqitet liste konceptet e lëndes, literatura, detyrimet e studentit për të shlyer gjithë përmbajtjen e disiplinës, format e vlerësimit deri tek penalteti në rastet kur nuk përmbushet programi lëndor nga ana e studentit/es. {Shih - Evidenca 11, Rregullorja e Programit - plani mësimor}
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuiivalentimit të studimeve.	Po. Studenti gjen në programin e studimit detajet e nevojshme dhe të domosdoshme që orientojnë atë rreth kriterëve të përgjithshme dhe atyre specifike që duhet të përmbushë, si dhe njëkohësisht e orienton studentin të kuptojë instrumentet ligjore kur Ai/Ajo mund të transferojë apo ekujvalentojë programin në rrethana të reja. {Shih Evidencë 11, }
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Po. Konfirmojmë që Programi është i organizuar në syllabuse të detajuara për cdo lëndë, përfshi dijen teorike, dijen që përvetësohet përmes ateljeve/ve, performancën, orët e detyruara në mësim, orët e punës individuale, sistemin e vlerësimit periodike dhe sporadic...e tjer. Të gjitha syllabuset janë organizuar në një format unik, por, duke ruajtur dhe respektuar profilin specifik të syllabusit referuar disiplinës. {Shih - Evidencën 22}
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të	Potencialisht Dosja e programit në fjalë, përmirësohet dhe pasurohet gjatë procesit. Në parim kjo është dhe detyrim ligjor i drejtuesve, njësisë për garantimin e cilesise, kordinatorit të programit, stafit akademik,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43428

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

13


vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	departamentit. Kjo konstatohet dhe në rregulloren e programit, rregulloren e mësmore, por, u konfirmua dhe nga bashkebiseda me drejtuesit e institucionit. Por, në programin në fjalë ende nuk konstatuam të kishte lindur nevoja për ndryshime aktuale.		
Konkluzione	Konfirmojmë standartin e përmbushur		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi i Programit Master në Arte: Piktura Monumentale dhe Mësuesi, e gjejme të arsyeshëm dhe ligjërish të korrekt. Dimensioni i Edukimit konsiderohet relativisht i plotë, në kuptimin që studenti merr mjaftueshëm dijen psiko-pedagogjike dhe didaktike për tu bërë Mësues. Currikula e profesionit të mësuesisë është funksionale, ajo zë rreth 70% të currikulës në total, bashkëngjitur dhe me orët e praktikës mësimore {150 ore} e vlerësojmë si relativisht të mjaftueshme për Diplomimin dhe më tej, punësimin e të diplomuarit në sistemin shkollor parauniversitar. {Shih- Evidencën 31. Kurrikula}
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Kurrikulat gjenden të formatuara në: Lëndë bazë, Lëndë karakterizuese, Lëndë kroskurrikulare, Lëndë me zgjellje, dhe praktika mësimore. Cdo lëndë është e fragmentuara në qëllime, objektiva, tema, metodologjinë e përvetësimit, literaturën, rezultatet e pritshme të të nxënit si dhe format e vlerësimit të studentit apo të grupit në varësi të detyrave që janë plani fikuar në kurrikul. Gjithcka gjendet e shkruar në dokumentet. {Shih RVB, Evidencë 29 dhe Rregulloren mësimore}
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Struktura e Programit Master në Arte "Piktura Monumentale dhe Mësuesi" shtrihet në semestra, përthyer në jave mësimore, në tema, koncepte, detyra individuale/grup referuar specifikës së disiplinës dhe profilit të programit. Referuar faktit që ky program Master në Arte dhe Mësuesi, ka specifika të theksuara pasi pikëpriten disiplina të ndryshme në funksion të mësuesisë, qartazi janë specifikuar aftësitë dhe kompetencat profesionale që pritet të fitojë student deri në marrjen e Diplomës. {Shih Evidenca 29}
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe	E konsiderojmë që Programi me mënyren e strukturimit, me llojin e disiplinave që përfshin, i programuar në orë dhe ECTS, është i

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	transferueshëm. Ky program hartuar në respect të ligjit dhe detyrimeve që ka Karta e Bolonjës garanton mobilitetin e studentëve. {Shih Evidenca 47 Mobiliteti i studentëve}						
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Konstatuam se në Syllabuse, pika e literaturës ishte e pasur dhe e përditësuar. Literatura ishte nga autoresi shqiptare dhe e huaj. Literatura sygjerohej fizike-literale, pamore dhe online. Kjo mundëson zhvillim të kopetencës mësimdhënëse dhe kopetencës artistike.						
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ ju komunikua se kërkesa për të rekrutuar personel akademik formulohet në Departament dhe UART shpall thirrje publike në përputhje me legjisllacionin në fuqi. Kriteret e përgjithshme hartohen nga burimet njerëzore dhe Njësia bazë ku parashikohen edhe specifikime në përputhje me Lëndën/ët dhe kategorinë për të cilat do të angazhohet stafi akademik. Kriteret publikohen edhe në web faqen e UART. Tek kriteret e punësimit është shumë e rëndësishme specifika e lëndës, kritere për të cilat kujdeset direkt Përgjegjësi i Departamentit. Pas miratimit të kërkesës dhe kritereve të pranimit, Rektori i Universitetit të Arteve, formulon dokumentin informues. Dokumenti shpallet publikisht në mediat e shkruara dhe ato elektronike si dhe në vende të dukshme të FAB. Pas dërgimit të dokumentacionit pranë Burimeve Njerëzore në Rektorat, Dekani i FAB krijon komisionin <i>ad hoc</i> për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve. Komisioni bën vlerësimin dhe renditjen e kandidaturave sipas rezultateve të vlerësimit. Kandidaturat e renditura sipas pikëve të fituara nga kriteret e përzgjedhjes, i dërgohen Rektorit. Rektori shpall fituesin sipas renditjes së tyre. Rektori vendos miratimin përfundimtar për të lidhur kontratën e punës me kandidatin/kandidatët e përzgjedhur.</p> <p><i>Shih Evidencë, Rregullorja e rekrutimit të stafit</i> http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=604&niveli=132</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ e konfirmon se UART mbështetur në kornizën ligjore në fuqi, përcakton organizimin e brendshëm akademik si dhe administrativ të tij, ku për realizimin e sukseshëm të programit të lëndëve rol të rëndësishëm luajnë edhe njësitë ndihmëse si struktura mbështetëse të UART që ndihmojnë institucionin, njësitë kryesore dhe njësitë bazë në realizimin e veprimtarisë mësimdhënëse, artistike-kërkimore-shkencore dhe ato administrative. Struktura administrative dhe ndihmës akademike në FAB përbëhet si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Kryetar dege në Fakultet -Krye Sekretar -Sekretar i Kurikulës dhe Mardhënie me Studentët -Laborantet -Punonjës te sherbimit <p>GVJ ju komunikua se edhe personeli ndihmës akademik dhe një pjesë e personelit administrativ, angazhohen në ndihmë të procesit mësimor nëpërmjet elementeve të tillë si zhvillimi i punëve të laboratorit në përputhje me programin e studimit, ndjekja e zhvillimit të praktikave mësimore, mirëmbajtja e bazës laboratorike, ndihmesa në zhvillimin e praktikave të diplomave etj. Për këtë synohet angazhimi i një personeli</p>

	<p>ndihmës akademik me kualifikim të lartë në fushën përkatëse. <i>Evidencë Nr.57. Lista dhe CV e stafit akademik ndihmës Njësia Bazë.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Bazuar në DVV dhe nga ajo që u komunikua gjatë vizitës në institucion, të gjitha të dhënat e personelit akademik që lidhen me kualifikimin e tyre, aktivitetin artistik, aktivitetin shkencor mbahen në dosjen personale të tyre të cilat administrohen nga Burimet Njerëzore. GVJ e konfirmon se dosja e stafit akademik është objekt përditësimi të përvitshëm dhe përmban të gjitha të dhënat e stafit akademik, ku stafi akademik udhëzohet që të përditësojë vazhdimisht CV e tyre, pasi aktivitetet e tyre artistike ndryshojnë dhe janë gjithmonë në rritje. Përveç dosjes së tyre janë CV dhe dokumentacioni mbështetës. Veprimtaritë e sipërpërmendura shoqërohen me dokumentacion vërtetues. <i>Evidencë Nr. 5. Udhëzimi Nr.29, datë 10.09.2018</i> <i>Evidencë Nr.91. VKM Nr.329, datë 12.04.2017</i> <i>Evidencë Nr.90. Realizimi i Marrëveshjeve vjetore Njësia Bazë</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë komunikimeve në Institucion me stafin akademik dhe me Dekanatin e FAB, GVJ ju komunikua se Studentët e Programit të Studimit Master i Arteve në "Pikturë Monumentale dhe Mësuesi", duhet të realizojnë praktikat mësimore pranë një institucioni të arsimit parauniversitar, në përputhje me parashikimet e planit mësimor dhe në mbështetje të lëndëve specifike të mësuesisë. Departamenti dhe FAB, nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi me institucionin pranë të cilit do të zhvillohet praktika ose me institucionin qendror. Në rastet e nënshkrimit të marrëveshjes me institucionin qendror, veç të tjerash, parashikohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkolla/t pranë të cilave do të kryhet praktika mësimore; - Numri i studentëve për çdo shkollë. <p>Në vazhdimësi Departamenti i FAB, përcakton një ose disa pedagogë, në varësi të numrit të studentëve për të ndjekur praktikën dhe për të mbajtur kontakt me institucionin pritës. <i>Evidencë Nr. 12. Rregullore Mësimore FAB</i> <i>Evidencë Nr. 26. Paketa e praktikës mësimore FAB, 2021.</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve/raportin përfundimtar të praktikës si dhe marrin pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. Marrëveshja parashikon angazhimin e një pedagogu, përfaqësues të FAB, në mbikëqyrjen e praktikës dhe një përfaqësues të institucionit pritës. Përfaqësuesi i institucionit pritës mbikëqyr dhe ndihmon studentin gjatë zhvillimit të praktikës, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar. Në përfundim të praktikës, përfaqësuesi i institucionit pritës, jep vlerësimin e tij për çdo student të mbikëqyrur. Praktika mësimore parashikohet si pjesë e planeve mësimore dhe përmban një numër kreditesh të caktuara, studentët e kanë të detyrueshme kryerjen e saj.</p>



	<i>Evidencë Nr. 26. Paketa e praktikës mësimore FAB, 2021.</i>		
Konkluzione	Standardi IV.1 është i përmbushur		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Sipas vizitës në institucion, infrastruktura e UART ishte e përshtatshme për përmbushjen e nevojave të mësimdhënies dhe veprimtarisë artistike, kërkimore – shkencore. UART, ka një sipërfaqe 13548 meter katror. Ndersa FAB ka një sipërfaqe 2475 metër katror. Për vetë natyrën specifike të programit të Studimit Master i Arteve në Pikturë Monumentale dhe Mësuesi, mjediset e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor, mundësojnë praninë e një numri të gjerë studentesh dhe garantojnë edhe cilësinë e programit. GVJ gjatë vizitës në Institucion vizitoi të gjitha këto ambiente dhe vërejtë që janë optimale e në përputhje me natyrën specifike të programit. Hapësira të veçanta ishin Atelietë ku studentët kompozonin në gjininë e pikturës monumentale, grafikës, skulpturës, modës dhe gjini të tjera. Këto atelje nuk kishin nevojë për pajisje teknologjike për shkak të specifikës së tyre ku proceset kryhen me dorë dhe me syrin e studentit dhe janë procese tërësisht individuale. Galeria FAB, me 3 hapësira dhe me një sipërfaqe 240m2, ishte një aset i rëndësishëm në përmbushjen e procesit krijues dhe në përmbijlljen e tij me ekspozimin e punëve të studentëve e pedagogëve, ekspozita sipas secilit program studimi. Ate e konsiderojnë si hapësira më atraktive në skenën e artit bashkëkohorë shqiptar, me rreth 30 aktivitete artistike në vit, dhe rreth 30 mijë vizitor, duke u kthyer në një arenë dialogu dhe ballafaqimi midis punëve të studentëve dhe publikut. Sipas kërkesave të projekteve edhe më të mëdha institucioni vë në dispozicion edhe mjedise tjera të përbashkëta. Referuar vizites ne IAL, FAB gjendet në godinën C të UART, në një ndërtesë e cila është përfudnuar në vitin 1972. Sipërfaqja totale e objektit është 1066 m2; nga të cilat 534 m2 janë sipërfaqe ambiente mësimi; 138 m2 janë sipërfaqe në funksion të zyrave; 47II. Salla e Lektorium Tonin Harapi, një mjedis i përbashket që përdoret nga secili program në varësi të projekteve artistike, sipas një kalendari të konfirmuar nga sekretaritet referuese. Planimetria e Katit 1 dhe 2 e organizuar në klasa mësimore kishte ndriçim natyral të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore.</p> <p><i>Evidencë Nr.61. Dosja e infrastrukturës FAB dhe ambienteve të përbashkëta</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Referuar vizitës fizikisht, një nga sallat në funksion të aktiviteteve artistike por edhe të ekspozitiva në funksion të programit MA në Pikturë Monumentale dhe Mësuesi është Galeria FAB si dhe hapësirat tjera, Salla "Black-Box".</p> <p>Mjediset mësimore, janë të paisura me kompjuter dhe videoprojektor funksional dhe akses të përhershëm internet.</p> <p>Po në këtë ndërtesë janë edhe 132 m2 të studiove në funksion të FAB. Mjediset mbështetëse të programit Pikturë Monumentale dhe Mësuesi, së bashku me infrastrukturën dhe pajisjet që disponojnë, janë në shërbim të realizimit jo vetëm të procesit mësimor por, edhe të projekteve artistike-kërkimore-shkencore të cilat e kanë nismën nga trupa pedagogjike, studentët, apo grupe të përbashkëta pedagogësh dhe studentësh.</p> <p><i>Evidencë. 58. Dokumentacioni me përshkrimin e aparaturave të laboratorit të Pikturës Monumentale</i> <i>Evidencë Nr.59. Dosja e infrastrukturës FAB dhe ambienteve të përbashkëta</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Deklarojmë se, studiot dhe laboratorët e FAB/UART janë të pajisura me aparaturat e nevojshme në funksion të realizimit të objektivave të Programit të Studimit Master i Arteve në "Pikturë Monumentale dhe Mësuesi", aparatura të cilat përmbushin kriteret për formimin teorik dhe praktik të objektivave të lëndëve në programin e studimit. Për vetë specifikën e programit të studimit pajisjet dhe aparaturat që përdoren në Departamentin e Pikturës në shërbim të realizimit të programeve speciale në pjesën më të madhe nuk janë pajisje dhe aparatura konvencionale siç përdoren rëndom në laboratorë formimi në IAL të tjera. Megjithatë studentëve u ofrohen mundësitë të njihen, prekin e përdorin, fjalën e fundit të teknologjisë në specifikën përkatëse.</p> <p><i>Evidencë. 58. Dokumentacioni me përshkrimin e aparaturave të laboratorit të Pikturës Monumentale</i> <i>Evidencë Nr.59. Dosja e infrastrukturës FAB dhe ambienteve të përbashkëta</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion kishte mjaftueshëm bazë teknologjike dhe infrastrukturë të natyrës së teknologjise, ku NJËSIA BAZË, shfrytëzon Laborator të Programit të Studimit Pikturë Monumentale. Në laboratorin e Monumentales ndodhet 1 kompjuter i pajisur me programet më të përdorura cdo element tjetër i nevojshëm si dhe një furrë profesionale të trajtimit të qelqit për teknikat e vitrazhit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet</p>	<p>Gjatë vizitës dhe bashkëbisedave të qëllimita në Institucion na u komunikua se praktikat e zhvilluara në programet e studimit në Departamentin e Pikturës, janë praktika profesionale artistike dhe praktika mësimore. Praktikrat profesionale artistike, në përputhje me specifikën e programit të studimit, materializohet në përfundimin e</p>


<p>marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>përvojave dhe perceptimin individual dhe artistike sipas programit për çdo disiplinë studimi. Këto praktika zhvillohen në ambientet e UART (atelje) me të gjithë infrastrukturën e nevojshme, ose në institucionet partnere të UART. Në kuadër të Programit të Studimit Master i Arteve në Pikturë Monumentale dhe Mësuesi” zhvillohen vetëm praktika mësimore. Praktikrat mësimore zhvillohen në marrëveshje me DAR dhe pranë institucioneve të arsimit parauniversitar. Në lidhje me këtë FAB kishte të nënshkruara marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><i>Evidencë Nr. 26. Paketa e praktikës mësimore FAB, 2021</i> <i>Evidencë Nr.27. Marrëveshje bashkëpunimi të FAB MAS, DRAP dhe ZVA-të.</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p>Standardi rezulton i përmbushur.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="590 707 762 786"></th> <th data-bbox="762 707 986 786">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="986 707 1185 786">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1185 707 1394 786">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="590 786 762 826"></td> <td data-bbox="762 786 986 826"></td> <td data-bbox="986 786 1185 826"></td> <td data-bbox="1185 786 1394 826">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<p>Standardi IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ deklaron se Literatura bazë dhe ndihmëse, për çdo lëndë të Programit të Studimit Master i Arteve në Pikturë Monumentale dhe Mësuesi, parashikohet në programin (syllabusin) e çdo lënde. Disponimi i literaturës bazë dhe ndihmëse parashikohet në përputhje me Rregulloren e FAB. Rrjedhimisht studentëve ju mundësohet qasja në literaturën e lëndës sipas formave të parashikuara:</p> <ul style="list-style-type: none"> - fizikisht (hard copy) në Bibliotekën e UART; - të shtypur (printuar nga vetë pedagogu), në rastin e leksioneve të hartuara (nëse e parashikon specifika e lëndës); - nëpërmjet paraqitjes së linkut ku mund të gjendet materiali i parashikuar. <p>Gjatë vizitës në Bibliotekën e UART, GVJ u qartësua në lidhje me Literaturën në funksion edhe të këtij programi studimi. Literaturë e përgjithshme (histori, sociologji, psikologji etj), si dhe monografi shkencore në gjuhën shqipe mbi artin para viteve '90 të cilat ishin në proces të dixhitalizimit, tituj të shumtë periodik, gazeta, revista si dhe artikuj të ndryshëm për art.</p> <p><i>uart.edu.al/katalog_biblio</i> <i>arkivi.uart.edu.al</i></p> <p><i>Evidencë Nr. 31. Kurrikulat e programit Master i Arteve në Pikturë</i></p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



32



	<p><i>Monumentale dhe Mësuesi</i> <i>Evidencë Nr. 61. Lista e literaturës Njësia Bazë në Bibliotekën e UART</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>GVJ ju komunikua se Departamenti i Pikturës në fillim të çdo viti akademik, njofton pedagogët e lëndëve për afatet e rishikimit të programeve të lëndëve (syllabuset). Për më tepër, Departamenti i Pikturës, nisur nga propozimet e pedagogëve të lëndëve dhe hulumtimet e kryera veçmas parashikon përditësimin e literaturës dhe pasurimin me materiale (libra, artikuj etj) të tjera.</p> <p>Lista e literaturës së detyrueshme është e përcaktuar qartë në Syllabuset e lëndës. Pjesa më e madhe e botimeve të reja ka të bëjë me revista e buletine artistike të vendeve kryesore Evropiane si dhe tituj veprash dramatike të cilat janë edhe elementi më i kërkuar nga pedagogët dhe studentët e Departamentit të Pikturës. Duhet theksuar se në mungesë të një tregu të mirëfilltë për botime të mirëfillta artistike/pedagogjike në gjuhën shqipe, literatura është kushtëzuar të jetë në gjuhët kryesore evropiane, kryesisht në anglisht dhe frëngjisht. Departamenti i Pikturës ka mundur të sjellë risi në sipërmarrjen e pedagogëve të saj për t'u bërë pjesë e përkthimeve të kolanave të klasikëve të mendimit teorik dhe praktik në gjininë e pikturës.</p> <p><i>Evidencë Nr. 61. Lista e literaturës NJËSIA BAZË në Bibliotekën e UART</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në funksion të studentëve që ndjekin këtë program studimi por edhe të gjithë studentëve të programeve që ofrohen në UART është edhe Biblioteka e UART. Gjatë vizitës në Bibliotekën e UART konfirmojmë profesionalizmin e Punonjësës e cila kishte njohje të theksuar për titujt por dhe kishte mjaftueshëm dije për atë literaturë që “mungon” në funksion të dimensionit didaktik, mësimor e edukim. Biblioteka e Universitetit të Arteve ka në përbërje dy salla (labororë) në shërbim të studentëve, salla e Fondit të Hapur dhe salla “Media Library”, të pajisura me infrastrukturë rrjeti kompjuterik fizik dhe valor, si dhe me pajisje kompjuterike të cilat përdoren nga studentët e të gjitha profileve të studimit në Universitetin e Arteve, për të tre Fakultetet përfshirë edhe studentët e Programit të Studimit Master i Arteve në Pikturë Monumentale dhe Mësuesi. Në këto salla mund të punohet me editim jo-linear audio, montazh fotografik, dizajn grafik, dizajn 3 dimensional, editim jo-linear video/ montazh filmik, dizajn inxhinierik, procese office, punë kërkimore shkencore, etj. Në këto salla aksesohen burimet elektronike të vetë Bibliotekës së Arteve, si dhe burime të shumta elektronike online, të cilat i janë mundësuar UART.</p> <p><i>Evidencë, Vizita në institucion</i> <i>Biblioteka online në web faqen e UART</i></p>

<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ ju komunikua se shërbimet elektronike të Bibliotekës së Universitetit ofrohen për anëtarët e saj përmes dy sistemeve, të cilat janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) sistemi i menaxhimit të integruar përmes të cilit Biblioteka kryen katalogimin dhe administrimin elektronik të fondit fizik të titujve të disponuar, kartelave elektronike, qarkullimin, etj., si edhe kryen shfaqjen përmes shfletuesit publik (OPAC) të titujve për audiencën e gjerë; 2) sistemi i arkivit digjital përmes të cilit përdoruesit kanë mundësi të shfletojnë materialet në trajtën elektronike (digjitale). <p>FAB/UART, ndjek një politikë të ruajtjes së trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore, nëpërmjet depozitimit në Bibliotekën e UART të materialeve të krijuara ndër vite.</p> <p>Biblioteka e UART i ofron koleksionet dhe shërbimet e saj nëpërmjet ambienteve si (sallë e cila i jep mundësinë përdoruesve të bibliotekës të shfrytëzojnë pa limit librin që dëshirojnë dhe duke fotokopjuar atë çka studentët dëshirojnë) dhe fondi i mbyllur (literaturë e artit figurativ, muzikor, dramatik si teori e arteve pamore, histori; punime teorike; përkthime; drama; tregime; romane, etj). Fondi i Bibliotekës përmban në total mbi 45,000 tituj.</p> <p><i>(Lista gjithëpërfshirëse e titujve fizikë në bibliotekën e UART)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Salla multimediale e Bibliotekës të UART ofronte kushte komode. Kjo sallë ishte e pajisur me teknologjinë e re, në shërbim të plotë të studentëve, pedagogëve, studiuesve të artit, tërësisht pa pagesë. GVJ gjatë vizitës ju komunikua se statistika për përdorimin e kompjuterëve ishte afërsisht nga 80 – 100 përdorues në ditë. Kjo sallë përveç arki vës digjitale, disponon edhe materiale të tjera audiovizuale në shirita në bobina, pllaka gramafoni, kasete, CD e DVD. Arkiva digjitale e aksesueshme e kësaj salle është krijuar nëpërmjet shfrytëzimit të sistemeve me bazë "kod me burim të hapur".</p> <p><i>(Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digjitale)</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në Bibliotekën UART, konstatoi se Biblioteka e UART ka edhe dy salla (labororë) në shërbim të studentëve, salla e Fondit të Hapur dhe salla "Media Library", të pajisura me infrastrukturë rrjeti kompjuterik fizik dhe valor, si dhe me pajisje kompjuterike të cilat përdoren nga studentët e të gjitha profileve të studimit në Universitetin e Arteve, për të tre Fakultetet përfshirë edhe studentët e Programit të Studimit Master i Arteve në "Pikturë Monumentale dhe Mësuesi". GVJ vërejti se në ambientet e bibliotekës ndodhej "Salla Multimediale" e cila është e pajisur me 20 kompjutera me qasje në internet të pajisur me software specifik në mbështetje të punës studimore edhe në fushën e muzikës. Sipas statistikave ato disponojnë:</p> <p><i>Salla me fonde të hapura (4 kompjutera);</i> <i>Salla multimediale (20 kompjutera);</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Zyrat e përpunimit të informacionit (6 kompjutera); Katalogu online (2 kompjutera); Paisje multifunksionale (3 Printera, 3 skanera, 2 fotokopje); Servera (3); Raku-Gramafon, manjetofon, kasetofon etj.</p>		
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka e UART funksionon bazuar në përcaktimet e Statutit të UART Neni 21 dhe rregullores së bibliotekës. Në përputhje me sa më sipër, biblioteka qëndron e hapur duke nisur prej orës 08:00, orë në të cilën nis edhe procesi mësimor, e në vazhdim deri në orën 19:00 (e hënë e enjte) dhe 8:00-16:00 (të premte). Në mënyrë të veçantë, përgjatë sezoneve të provimeve, biblioteka e UART, për të plotësuar kërkesat e shtuara të studentëve dhe stafit akademik, punon me orar të zgjatur, bazuar në kërkesat e Fakulteteve të UART. Biblioteka e UART, e klasifikuar në llojin Bibliotekë Universitare, luan rolin e një biblioteke speciale për të gjitha fushat e artit në Shqipëri dhe ndihmon në mënyrë të drejtpërdrejtë në edukimin dhe formimin e artistëve. Mbështetja e procesit mësimor, veprimtarisë krijuese artistike-shkencore si dhe shërbimet që ofron ndaj kërkuesëve e artistëve nga institucione të ndryshme të artit janë parimet bazë të funksionimit të saj.</p> <p><i>Evidencë Nr.60. Rregullore/manual i bibliotekës/foto të sallës, aparataturat.</i> http://www.artacademy.al/index.php?pg=faqe&id=92&niveli=66</p>		
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>GVJ ju komunikua se Biblioteka e UART informon rregullisht Njësitë Bazë për mundësitë dhe fondet e vëna në dispozicion të pasurimit të literaturës. Bazuar në njoftimin e bibliotekës, paraqet kërkesat e saj për literaturën e nevojshme dhe pasurimin e fondit të bibliotekës në funksion të Programit të Studimit Master i Arteve në Pikturë Monumentale dhe Mësuesi. Gjithashtu, biblioteka raporton për fondin fizik në dispozicion (tituj, tekste, drama, revista, buletine, etj) dhe frekuentimin e ambienteve të bibliotekës sikurse dhe online. GVJ ju komunikua se shefat e departamentit shkojnë rregullisht në bibliotekë ku verifikojnë literaturën përkatëse të degëve të tyre dhe bëjnë kërkesat specifike.</p> <p><i>Evidencë Nr. 92. Lista gjithëpërfshirë e titujve fizikë në bibliotekën e UART.</i> <i>Evidencë 93. Statistika të aksesit të Bibliotekës së UART.</i> <i>Evidencë 94. Procedurë dhurimi për Bibliotekën.</i></p>		
Konkluzione	Standardi rezulton i përmbushur		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Menaxhimi i informacionit që lidhet me aktivitetin e studentit në FAB garantohet nga Rregulloret përkatëse, mbi të gjitha nga Rregullorja e Sekretarisë mësimore. UART gjithëashtu siguron menaxhimin e informacionit dhe të dhënave për studentët dhe stafin akademik edhe nëpërmjet web-it (www.uart.edu.al/). Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me mbajtjen edhe në format letër të Rregjistrimit themeltar, Rregjistrimit të arritjeve akademike, Rregjistrimit të kursit dhe Rregjistrimit të diplomave si dhe me dokumentacionin e dorëzuar nga studenti në momentin e regjistrimit/transferimit. Për tu regjistruar në Programin e studimit Masteri i Arteve në Pikturë Monumentale dhe Mësuesi, studenti dorëzon dosjen me të dhënat personale dhe CV. Për menaxhimin e informatizuar të informacionit në FAB përdoret sistemi Pitagora, i cili është i bazuar në një platformë online, i aksesueshëm nga të gjithë studentët, stafi administrativ (sekretaritë) dhe ai akademik i FAB, nëpërmjet një Username-i dhe Fjalëkalimi.</p> <p><i>Evidencë RVB; Vizita në institucion</i> <i>Evidencë Nr.12 dhe 52. Rregullorja mësimore FAB dhe Rregullorja e Sekretarive FAB</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Konfirmojmë se Sistemi Pitagora është sistem i ri, i vënë në funksion në këtë vit akademik. GVJ ju komunikua se para këtij Sistemi, UART ishte një nga Institucionet e para e cila përqafoi sistemin elektronik ESSE 3. Edhe pse sistemi i përdorshëm tani, ai Pitagora është në përmirësim të vazhdueshëm dhe GVJ edhe në këtë rast është i mendimit se ky sistem shërben për të menaxhuar plotësisht informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit si dhe është detyrim i stafit akademik që në përfundim të çdo viti akademik të përditësojë dosjen e tij fizike pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.</p> <p><i>Evidencë Nr. 5. Udhëzimi Nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar me Udhëzimin e MASR Nr. 37 datë 4.12.2018, "Për një ndryshim në Udhëzimin Nr.29 datë 10.09.2018".</i> <i>Evidencë Nr.90. Realizimi i Marrëveshjeve vjetore NJËSIA BAZË.</i></p>

<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit nëpërmjet sistemit Pitagora i cili mundësohet nëpërmjet sekretarisë mësimore, e cila ka një hyrje dedikuar studentëve dhe stafit nëpërmjet adresës email dhe fjalëkalimit të personalizuar. Me anë të këtij sistemi i mundësohet sekretarive mësimore të hedhin online rezultatet e provimeve për studentët, të ndarë sipas grupeve dhe programeve përkatëse. Nëpërmjet web-it (www.uart.edu.al/) bëhet sigurimi i informacionit dhe dokumentacioneve të nevojshme për studentët dhe stafin akademik.</p> <p><i>Evidencë Nr. 51. Manuali IT, UART</i> <i>Evidencë Nr.65. Foto nga sistemi PITAGORA</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ ju komunikua se Sistemi i integruar PITAGORA është një platformë e cila siguron këmbimin e informacionit mes studentit, sekretarisë FAB, pedagogut. Nëpërmjet këtij sistemi vlerësimi i pedagogut për studentin në një lëndë specifike, pasqyrohet në kohë reale në adresën personale të studentit brenda të njëjtit sistem.</p> <p>Ky sistem siguron një sërë të dhënash si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Njoftimin rreth datave të provimeve, vlerësimit të marrë dhe librezën e notave;</i> - <i>Shkarkimin e vërtetimeve të ndryshme që mund të konsiderohen të nevojshme për studentët;</i> - <i>Njoftimin në kohë reale të notave apo mënyrave të tjera të vlerësimit të studentëve.</i> <p><i>Evidencë Nr.51. Manuali IT, UART.</i> <i>Evidencë Nr.65. Foto nga sistemi PITAGORA</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Referuar RVB, sistemi i menaxhimit në FAB, garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe u mundëson studentëve informacion mbi vlerësimet, mungesat, provimet etj. Ndërkaq sistemi prodhon edhe raportime individuale ose të përgjithshme me të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. Realizimi i veprimtarisë akademike dhe artistike/shkencore të personelit akademik verifikohet në përputhje me Rregulloren e FAB.</p> <p><i>Evidencë Nr.12. Rregullore Mësimore FAB.</i> <i>Evidencë Nr.95. Fletëprezenca të pedagogëve në orën e mësimit.</i> <i>Evidencë Nr.96. Kërkesa e pedagogut për leje për krijimtari apo aktivitet</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqja web (www.uart.edu.al/) e UART ofron një informacion të zgjeruar mbi institucionin në përgjithësi si dhe programin e studimit Master i Arteve në "Pikturë Monumentale dhe Mësuesi". Gjithashtu, nëpërmjet web faqes, mund të merret informacion i zgjeruar për stafin akademik, informacion mbi kriteret e pranimit, tarifat e studimit, përfitim e bursave të studimit dhe çdo lloj informacioni tjetër, që ka të bëjë me aktivitetet e përditshme të Intitucionit. Ndërkohë, në faqen web ndodhet një seksion i veçantë për studentët, ku gjenden informacione për</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	aktivitetet e tyre të përditshme. Për informacionet e përgjithshme web faqja mund të aksesohet nga çdo përdorues. Disa Informacione në web faqe mund të ofrohen edhe në gjuhën angleze. Për rastet e aktiviteteve të cilat kanë përmbajtje në më shumë se një gjuhë, publikimi bëhet në gjuhën shqipe bashkë me linkun për gjuhën tjetër të aktivitetit. <i>Evidencë Nr.63. Faqja web me njoftime, UART</i>		
Konkluzione	Konstatohet se programi në fjalë, disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit, administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativë.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<p>Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë. Hartimi i Projekt Buxhetit afatmesëm dhe buxhetit të përvitshëm, përpos planifikimit të fondit të pagave për stafin akademik me kohë të plotë dhe afat të pacaktuar, bazohet në kërkesat e Njësisë Bazë. Njësia bazë dhe FAB nuk kanë drejtori ekonomike Brenda njësisë kryesore dhe për hartimin e projekt-buxhetit bashkëpunon me drejtorinë ekonomike në nivel universiteti. Planifikimi financiar nis çdo fillim vit kalendarik bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010. Në kërkesat e paraqitura në funksion të mbështetjes financiare të programeve të studimit në varësi të saj, Njësia Bazë e programit Pikturë Monumentale dhe Mësuesi në FAB përqëndrohet në:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Parashikimin e stafit akademik më kohë të plotë; 2. Sigurimin e bazës materiale; 3. Parashikimin e mbështetjes së veprimtarisë artistike dhe kërkimit shkencor. <p>Projektbuxheti, parashikon të gjitha kostot e mbulimit financiar të programit të studimit dhe pasi miratohet në Senatën Akademik dhe Bordin e Administrimit, i përcillet për miratim përfundimtar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.</p> <p><i>Evidencë Nr.97. Paraqitja e buxhetit nga administrator i FAB.</i> <i>Evidencë Nr.98. VSA për miratimin e buxhetit.</i> <i>Evidencë Nr.99. Vendimi i Bordit të Administrimit për buxhetin.</i></p>

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>GVJ ju komunikua se në hartimin e projektbuxhetit dhe mbështetjen efektive financiare të programit të studimit merren parasysh kërkesat e paraqitura nga Njësia Bazë përgjegjëse për Programin e Studimit Master i Arteve në "Pikturë Monumentale dhe Mësuesi". Përpos detajimit të kërkesave për PBA, përpara fillimit të çdo viti akademik, Njësia Bazë paraqet kërkesën për stafin akademik me kohë të plotë dhe atë me kohë të pjesëshme. Financimi i stafit akademik me kohë të plotë sigurohet nga buxheti i shtetit ndërkohë që stafi akademik me kohë të pjesëshme mbulohet financiarisht nga të ardhurat e vetë institucionit. Gjithashtu institucioni, bazuar në planifikimin financiar, siguron mbështetjen financiare për të gjitha shpenzimet e tjera që lidhen me programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Pavarësisht që UART raporton në mënyrë periodike në MASR pasqyrat vjetore financiare. GVJ deklaron se UART, për periudhën në të cilën shtrihet edhe vlerësimi i programit në kuadër të akreditimit, nuk i është nënshtruar ndonjë auditimi financiar. GVJ u interesua pse UART nuk zhvillon auditim dhe përgjigja ishte se , UART nuk plotëson kushtet për të patur një Strukturë të Auditimit të brendshëm, mbështetur në VKM Nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e krijimit të njësisive të auditimit të brendshëm në Sektorin publik", pika 1, b. Megjithatë UART raporton në mënyrë periodike në MASR pasqyrat vjetore financiare.</p> <p><i>Evidencë Nr. 100. Pasqyrimi financiar vjetor i vitit 2020</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. Drejtoria Ekonomike e UART paraqet çdo vit analizën për veprimtarinë ekonomike të institucionit. Në këtë analizë vjetore zënë vend raportimi mbi realizimet e zërave sipas parashikimeve të bëra në projekt buxhet dhe realizimeve konkrete të tyre. Zërat në raport përfshijnë: investimet, fondin e pagave, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, mallrat dhe shërbimet e tjera, transferimet korrente për jashtë, ndihmë për individët dhe bursa. Çdo zë paraqitet me peshën specifike në buxhetin total të vitit. Po e njëjta procedurë ndiqet edhe për realizimin e buxhetit për vitin në fjalë. Më pas vijon paraqitja e realizimit të buxhetit sipas zërave dhe bazuar në burimet e financimit për çdo zë. Në finale çdo zë zbërthehet në nënzërat përkatës edhe me detajimin e</p>

	<p>përqindjeve specifike të realizimit sipas projektbuxhetit. Ky raport kalon më pas për miratim në Senatën Akademikë të UART sipas parashikimeve të ligjit.</p> <p><i>Evidencë Nr.108. Të ardhura që parashikohen të realizohen nga UART Janar – Maj 2022</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ ju komunikua se deri më tani institucioni nuk ka pasur nevojë të ndërhyjë në përmirësimin e situatës financiare. Gjithësesi Departamenti i Pikturës në FAB në përmbushje të misionit për të ofruar një mësimdhënie sa më cilësore si në kushte e në mjete moderne të teknologjisë ka apikuar me projekte të cilat do të ishin një burim shtesë të ardhurash.</p> <p><i>Evidencë Nr.107. Rishpërndarja e të ardhurave dhe shtesa në regjistrin e prokurimeve.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p>Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje,</p>	<p>GVJ konstaton se UART ka të hartuara një sërë dokumentash regullative që mbulojnë studentët që nga fillimi i studimeve deri në fund të studimeve. Gjithashtu ky institucion zbaton politika dhe procedura mbi të cilat mbështetet cikli i plotë i programit të studimit Master i Arteve në “Pikturë Monumentale dhe Mësuesi”, si: - ligji nr.80/2015 “Për arsimin</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, - legjislacionin në fuqi, në VKM-së Nr.145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë UA si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe <i>Statuti i UART, Rregullorja e Institucionit, Rregullorja e ciklit të dytë të studimeve, Rregullorja e Departamentit të Pikturës, Rregullorja e programit të Studimit Master i Arteve në “Pikturë Monumentale dhe Mësuesi”, Rregullorja e Sekretarisë mësimore, etj.</i> Të gjitha Rregulloret e mësipërme janë të mbështetura në Ligjin e Arimit të Lartë dhe Akteve nënligjore në fuqi si dhe janë të miratuara me Vendim të Senatit Akademik dhe janë lehtësisht të aksesueshme në web faqen (www.uart.edu.al) <i>Evidencë Nr.1. Urdhri i MASR Nr.821, datë 26.12.2018</i> <i>Evidencë Nr. 2. Ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”</i> <i>Evidencë Nr. 9. VKM Nr. 145, datë 10.03.2021</i> <i>Evidencë Nr.29. Rregullore mësimore e UART</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>FAB, ashtu si edhe i gjithë UART, ka politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje që garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. GVJ konstaton se UART ka në vizionin e tij:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, në fushën e artit dhe kulturës si dhe të nxisë e të zhvillojë kërkimin artistik-shkencor; b) të formojë specialistë të lartë të fushave të arteve dhe të përgatisë artistë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit; c) të ofrojë mundësi të barabarta për të përfutuar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës; d) të kontribuojë në zhvillimin artistik, ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal; e) të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit; f) të integrojë mësimdhënien me kërkimin artistik-shkencor; g) të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë dhe më gjerë; h) të nxisë formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të artit e kulturës; i) të nxisë thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistit të lartë në fushën e artit e kulturës; j) të ofrojë mundësi për kryerjen e studimeve artistike-kërkimore-shkencore për të zhvilluar e tejçuar artin e kulturën; <p>Të gjitha kriteret, procedurat apo ndonjë kërkesë ka qasje në web faqen zyrtare të UART, si dhe nëpërmjet zyrave përkate të institucionit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti</p>	<p>GVJ ju komunikua se: UART harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u</p>

<p>akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>pranuar në programin e studimeve në të gjitha programet e ciklit të dytë që ofrohen në UART, ashtu edhe në programin Master i Arteve në Pikturë Monumentale dhe Mësuesi pranimit e studentëve bëhen sipas Konkursit dhe studentët i nënshtrohen konkurseve të pranimit. Kriteret e pranimit për ciklin e dytë të studimeve përcaktohen sipas rregullores të miratuar nga Senati Akademik i UART. Studenti i interesuar mund ta marrë këtë informacion si në web faqen e UART, ashtu edhe në Sekretarinë mësimore të Fakultetit, por edhe nga përgjigjet që jep Sektori mësimor nëpërmjet email, ose në rrjetet sociale si Facebook, Instagram. Ashtu siç është edhe lehtësisht e verifikueshme duke parë Rregulloren e programit të studimit, kriteret për regjistrimin e studentëve. Shih <i>Rregullorje Mësimore FAB, neni 24</i>. Ky urdhër publikohet në rubrikën njoftime në ambientet e Fakultetit të Arteve të Bukura si dhe në të gjitha faqet elektronike të Institucionit.</p> <p><i>Evidencë Nr.68. Vendime të Senatit Akademik</i> http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=569&vivali=105</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Duke parë rregulloren e programit të studimit për kriteret dhe procedurat e pranimit, të transferimit të studimeve si dhe kriteret e diplomimit janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e Veprimtarisë së Përgjithshme dhe Mësimore të FAB si dhe në manualin e transferimeve.</p> <p><i>Evidencë Nr.12. "Rregullorje Mësimore e FAB", Neni 24</i> <i>Evidencë Nr.33. Rregullore e Prog.Stud. Master i Arteve në Pikturë Monumentale dhe Mësuesi.</i> <i>Evidencë Nr.101. Manuali i Transferimeve</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, UART në përgjithësi por edhe FAB si njësi kryesore për ofrimin e këtij programi studimi informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit të cilat bëhen publike në web faqen e Fakultetit dhe në ambientet e përcaktuara pranë FAB. GVJ ju komunikua se në mbështetje të informimit të publikut si dhe kandidatëve të mundshëm, institucioni organizon përpara fillimit të çdo viti akademik, takime të hapura të stafit akademik me kandidatët e interesuar për të ndjekur programet Master, duke u shpjeguar kriteret, procedurat, tarifat dhe mundësitë e regjistrimit në programet që të interesuarit shfaqin interes, mundësitë e mobiliteteve etj. Për shkak edhe të natyrës specifike të programit, studentët që ndjekin studimet e ciklit të parë bachelor, janë pothuajse të gjithë të interesuar të ndjekin edhe studimet e ciklit të dytë Master. GVJ ju komunikua po ashtu se procedurat e konkurseve të pranimit si dhe të gjitha detajet për organizimin dhe mirëfunksionimin e stafit administrative dhe akademik janë nën zbatimin e një Urdhri të posaçëm nga Rektori, ku Dekani i FAB ngre grupin e punës si dhe përcakton detyrat dhe afatet në zbatim të akteve nënligjore për konkurset e pranimit. Ky urdhër publikohet në</p>

	<p>web faqe si dhe në të gjitha faqet elektronike të UART.</p> <p><i>Evidencë Nr.12. "Rregullorje Mësimore e FAB", Neni 24.</i> <i>Evidencë Nr.66. Vendime të Senatit Akademik "Mbi miratimin e rregulloreve dhe kritereve të konkursit të pranimit për vitin akademik 2022-2023" për FAB</i> <i>Evidencë Nr.68. Vendime të Senatit Akademik "Për deklarimin e kuotave të pranimit të studentëve të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë bachelor dhe të ciklit të dytë master për vitin akademik 2022-2023 në Universitetin e Arteve".</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Në takimin e fundit GVJ ju komunika se FAB nuk harton kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta apo të pakicave dhe shtresave të marginalizuara por, përcakton kuota pranimi të veçanta për këto shtresa, si dhe për studentët që vijnë nga shtresa sociale "Rome/ Ballkano-Egjiptiane", FAB / UART ndjek politikë mbështetëse për këtë kategori, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në zbatim të këtyre akteve parashikohen kriteret për përfitimin e bursave në bazë të kategorive përkatëse, të cilat ndryshojnë çdo vit akademik.</p> <p><i>Evidencë Nr.67. Kuotat e kërkuara në MAS nga FAB për vitin akademik 2020-2021.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>GVJ ju komunikua që Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Sipas Rregullores së programit të studimit Master, të drejtën e konkurrimit e kanë edhe kandidatët që kanë një diplomë të një vendi të huaj e cila është ekuivalente sipas legjislacionit në fuqi. Bazuar në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe si dhe legjislacionin në fuqi, studimet në FAB mund t'i ndjekin edhe studentët shtetas të huaj. Studimet në FAB si program të dytë studimi, mund ti ndjekin edhe shtetas shqiptarë e të huaj që kanë përfunduar studimet e larta, kundrejt konkursit të pranimit si dhe pagesës së tarifës të miratuar nga Bordi i Administrimit, mbështetur në Vendimin e Senatit Akademik.</p> <p><i>Evidencë Nr. 12. Rregullore Mësimore e FAB, neni 24.</i> <i>Evidencë Nr.33. "Rregullorja e programit të studimit programit të studimit Master i Arteve në Pikturë Monumentale dhe Mësuesi.</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>GVJ ju komunikua se studentët që vijnë nga shtresa sociale (në nevojë) si dhe studentët me aftësi të kufizuara, UART ndjek politikë mbështetëse për këto kategori, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në zbatim të këtyre akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi parashikohen kriteret edhe për përfitimin e bursave në bazë të kategorive përkatëse, të cilat ndryshojnë çdo vit akademik. Kjo kategori përfiton bursë në masën 100% ose 50%. UART zbaton procedurat për pranimin e dokumentacionit sipas anës ligjore dhe nënligjore, për secilin aplikues</p>

	sipas kategorive, dhe miraton përfituesit.		
	<p><i>Evidencë Nr.35. VKM për përjashtimin e nga pagesa të studentëve Romë/Balkani-Egjiptianë.</i></p> <p><i>Evidencë Nr. 102. VKM nr 780, dt 26.12.2018. Për "përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për uljet e tarifës vjetore..."</i></p>		
Konkluzione	GVJ konstaton se FAB si dhe Departamenti përgjegjës për ofrimin e programit të studimit MA në "Pikturë Monumentale dhe Mësuesi", ka hartuar politika dhe procedura për pranimin e studentëve duke i ndjekur me rigozitet dhe duke i zbatuar ato.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>GVJ ju konfirmua se kriteret dhe procedurat e kalimit të studentëve nga njëri vit akademik në tjetrin janë të bazuara dhe rregulluara sipas Rregullores së programit të studimit MA në "Pikturë Monumentale dhe Mësuesi". Institucioni informon për vlerësimet për secilën lëndë të zhvilluar gjatë gjithë vitit akademik. Në këtë Rregullore ishin të përcaktuara të drejtat dhe detyrat e studentëve, zhvillimi i provimeve, e drejta për të hyrë në provim, kriteret dhe procedura të vlerësimit, dokumentimi i vlerësimeve, komunikimi i vlerësimeve, transferimi i studimeve, ndërprerja dhe rifillimi i studimeve, etj.</p> <p>Gjithashtu GVJ ju bë e ditur se përmes sekretarisë mësimore, web faqes së UART (www.uart.edu.al) dhe sistemit PITAGORA, jepet informacion lidhur me të gjithë procesin dhe përparimin akademik të studentëve.</p> <p><i>Evidencë Nr.12. "Rregullorje Mësimore FAB, Kushtet e kalimit në vitin pasardhës, Kreu V, Neni 41, 42, 43, 44.</i></p> <p><i>Evidencë Nr.33. "Rregullorja e programit të studimit programit të studimit Master i Arteve në Pikturë Monumentale dhe Mësuesi.</i></p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>GVJ ju komunikua se mbështetur në Rregulloren e programit të studimit, kriter bazë për pranimin në studimet e këtij programi studimi, MA në "Pikturë Monumentale dhe Mësuesi", është studimi i plotë i programit Bachelor në Pikturë Monumentale, si dhe kriteret tjera që përcaktohen qartë në rregulloren e UART. Kriteri kryesor është konkursi dhe pranimi në këtë program studimi. Të drejtën e konkurrimit e kanë edhe kandidatët që kanë një diplomë "Bachelor" të një vendi të huaj e cila</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>është ekuivalente sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Studimet në këtë program mund t'i ndjekin edhe:</p> <ol style="list-style-type: none"> studentë shtetas të huaj, bazuar në marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe si dhe legjislacionin në fuqi. shtetas shqiptarë e të huaj që kanë përfunduar studimet e larta, kundrejt pagesës së tarifës të miratuar nga Bordi i Administrimit, mbështetur në vendimin e Senatit Akademik. <p><i>Evidencë Nr.70. Rregullore e Programit të Studimit, Pranimi i studentëve, Neni 11.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ ju komunikua se Sekretaria mësimore e FAB i informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. Pedagogët e lëndës, për secilin program studimi, kanë përfshirë vlerësimin e studentit, peshën që zë vlerësimi sipas komponentëve si dhe shpërndarjen e komponentëve të vlerësimit. GVJ ju komunikua se mësimdhënia është e organizuar në mënyrë individuale për lëndët speciale dhe në grupe të vogla dhe të mëdha për lëndët artistike/lëndët e formimit bazë. Sipas të dhënave nga sekretaria mësimore e FAB edhe pedagogët në mënyrë individuale kryejnë informimin e studentëve lidhur me programin e lëndëve, procesin mësimor, sezonin e provimeve, sistemin e vlerësimit dhe detyrimet vjetore që ka studenti në lidhje me programin/fushën specifike ku ai studion.</p> <p><i>Evidencë Nr.70. Rregullore e Programit të Studimit, Dokumentimi i vlerësimit të studentëve, Neni 22.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ u informua se Institucioni i arsimit të lartë në mënyrë të vazhdueshme informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. GVJ gjithashtu u informua se realizimi i temës së diplomës përbën një element shumë të rëndësishëm në procesin e diplomimit në programin e studimit Master i Arteve në "Pikturë Monumentale dhe Mësuesi". Sipas Rregullores së Programit të Studimit Master, në planin mësimor kriteret dhe procedurat e realizimit të temës së diplomës, dhe diplomimit janë të rregulluara qartë dhe u bëhen të njohura studentëve nëpërmjet Departamentit të Pikturës, në mënyrë të vazhdueshme, duke ju dhënë informacione të detajuara lidhur me përgatitjen dhe procesin e diplomimit. Gjithashtu studentëve ju jepej informacion për përmbushjen e kriterëve për diplomimin, caktimin e pedagogut udhëheqës si dhe për politikën e plagjaturës.</p> <p><i>Evidencë Nr.33. Rregullore e Programit të Studimit MA në Pikturë Monumentale dhe Mësuesi, Neni 32, 34, 35.</i></p>

<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ ju sqarua mënyra se si funksiononte UART në përgjithësi, FAB dhe Departamenti i Pikturës në veçanti për mënyrën sesi ky institucion mundohet të tërheqë sa më shumë kandidatë për studentë në programet që ofron, si dhe sa i hapur është me publikun. Faqja zyrtare www.uart.edu.al, panairët e organizuara nga MAS, si dhe faqja më e re e informimit matura shtetërore, në portalin U-Albania të administruar nga Zyra e Sektorit mësimor në bashkëpunim me TI dhe informimit, japin informacionin e duhur ku në kohë reale kandidatët pyesin dhe marrin përgjigje për secilën problematikë të ngritur prej tyre. Për një informacion edhe më të madh ata përdorin edhe rrjetet sociale <i>Facebook, Instagram, LinkedIn, Google+ dhe Youtube</i>, ku një pjesë e studentëve kishin edhe llogari aktive në këto platforma. Në UART përveç kandidatëve të huaj synohet edhe informimi i nxënësve të shkollave të mesme, për ti nxitur që të mund të ndjekin talentin e tyre në fushën e përzgjedhur.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>Konstatohet se UART në përgjithësi dhe FAB dhe Departamenti i Pikturës në veçanti, vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit të tyre.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

<p>Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Sipas takimeve në institucion GVJ u informua se Programet e publikuara në faqen zyrtare gjenden sipas kategorive psh.: Fakulteti i Arteve të Bukura, Programet e studimit: Departamenti i Pikturës, ku për secilin program, sipas departamenteve janë hedhur të dhënat kryesore, në të cilat gjendet edhe programi i planit mësimor. GVJ ju ofrua katalogu fizik me të gjitha informacionet e programeve të studimit në FAB ku studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën në funksion të realizimit të tij. GVJ konstaton gjithashtu se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Ky informacion u transmetohet që në javën e parë të fillimit të procesit mësimor gjatë prezantimit të syllabuseve të lëndëve, detyrimeve përkatëse, mënyrës së shlyerjes së tyre dhe infrastrukturës në dispozicion të tyre. Informacioni në lidhje me këta elementë shpërndahet edhe përmes sekretarisë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>mësimore e cila luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve, notat etj. (<i>Evidencë Takime në institucion</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstaton se një burim i rëndësishëm informacioni për studentët përveç informimit të tyre nga pedagogu i lëndës në lidhje me modulet, lëndët, veprimtaritë formuese të programit, etj janë të publikuara edhe në web faqen e UART www.uart.edu.al</p> <p>Nëpërmjet kësaj web faqeje studentët mund të kenë aksesë dhe të marrin gjithë informacionin që dëshirojnë rreth programit të studimit. E gjithë baza rregullative e UART është e printuar në formatin fizik <i>hard copy</i> për përdorim të përgjithshëm dhe gjenden në Bibliotekën e UART dhe pranë departamenteve. Për komunikimin në kuadër të realizimit të procesit mësimor për programin e studimit përdoret edhe Sistemi Pitagora, sistem i cili është bërë i mundur të aplikohet nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH) për të gjithë Institucionet e Arsimit të Lartë publik që kanë dashur të jenë pjesë e këtij Sistemi. (<i>Evidencë Takime në institucion dhe RVB</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>GVJ ju komunikua se realizimi i programeve mësimore mbështetet në metodat që vënë theksin tek studentit, si dhe që kërkojnë formimin e njohurive hap pas hapi. Studentët e UART janë të përfshirë edhe në jetën artistike kulturore të vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në ekspozita dhe aktivitete të tjera artistike në institucionet kryesore të Tiranës (Galeria Kombëtare e Arteve) apo galeri të tjera private. Ky bashkëpunim është rritur edhe më tej nëpërmjet marrëveshjeve që UART ka realizuar me institucionet kulturore artistike në kuadër të iniciativës “Paktit për Universitetin”.</p> <p>Referuar RVB, programet dhe riorganizimi i tyre, janë të përshtatshme për t’iu përgjigjur tregut të punës. Këtij qëllimi i ka shërbyer Urdhëri i MASR Nr. 821, datë 26.12.2018 dhe Nr. 512, datë 24.10.2019, si dhe zbatimi i Udhëzimit të MASR Nr.52, dt.03.12.2015, i ndryshuar për gjuhët e huaja.</p> <p><i>Evidencë Nr. 6. Udhëzimi i MAS nr. 52, dt. 03.12.2015</i> <i>Evidencë Nr. 20. Marrveshje ndërmjet institucioneve të artit në Shqipëri.</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Duke u bazuar edhe në syllabuset e programeve të studimit Master të Arteve në “Pikturë Monumentale dhe Mësuesi”, studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Elementë të tjerë si orari i mësimave, struktura e vitit akademik, formularë të ndryshëm, modele të testimeve/provimeve që përdoren në institucion, aplikime për bursë, mund të aksesohen në ambientet e hapura në FAB, po ashtu edhe nëpërmjet web faqes së institucionit. Sipas asaj që na u komunikua, një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan dhe Sekretaria Mësimore e FAB e cila mban kontakte të rregullta me studentët që</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafaj», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	ndjekin programin e studimit nëpërmjet komunikimeve elektronike (email-it zyrtar). <i>Evidencë: www.uart.edu.al</i> <i>Evidencë Nr.40. Syllabuset</i>								
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Studentët na deklaruan se nga ana e pedagogëve përkatës, në fillim të çdo semestri njihen me të gjithë programet (syllabuset), ku jepen në detaje detyrimet e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar. Studentët e Programit të Studimit Master i Arteve në “Pikturë Monumentale dhe Mësuesi”, aksesojnë sistemin Pitagora përmes aksesit që ata kanë në emailin e tyre dhe mund të marrin informacion për ecurinë në programin e studimit në çdo kohë. Qasja është elektronike dhe studenti mund ta përdori sistemin nga të gjitha formatet elektronike, qofshin ato smartphone, tablet, PC, etj., mjafton që studenti të ketë akses në adresën e tij elektronike dhe të vendosë fjalëkalimin e saktë. <i>Evidencë Nr.40. Syllabuset për programin e studimit Master i Arteve në “Pikturë Monumentale dhe Mësuesi”.</i>								
Konkluzione	Konstatojmë se UART vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	UART disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. Në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me mbajtjen në format letër të Rregjistrimit themeltar, Rregjistrimit të arritjeve akademike, Rregjistrimit të kursit dhe Rregjistrimit të diplomave si dhe me dokumentacionin e dorëzuar nga studenti në momentin e rregjistrimit apo edhe të transferimit. Një nga strukturat më të rëndësishme për mbajtjen e statistikave të studentëve si ato që ndjekin programin e studimit por edhe atyre studentëve që janë diplomuar është sekretaria mësimore e FAB e cila funksionon mbi bazën e detyrave të përcaktuara në Rregulloren e Sekretarisë Mësimore. Mbajtja e statistikave të studentëve mbahet edhe në Sektorin e Statistikave, pjesë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në UART. Sipas Sekretarisë Mësimore të FAB, për arsye të ruajtjes së konfidencialitetit jo gjithëmon këto të dhëna janë objekt i bërjes publike.

<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga Sekretaria Mësimore GVJ u informua për statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Sekretaria i ruan të dhënat në regjistra përkatës dhe në formë elektronike. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh edhe me dokumentacionin që ka të bëjë me studentët e pranuar në programin e studimit Master i Arteve në "Pikturë Monumentale dhe Mësuesi". Rregjistrimet, përfshirë transferimet, për studentët të regjistruar për herë të parë në vitin e parë, si dhe studentët e diplomuar në këtë program studimi, psh.: për vitin 2021-2022, paraqiten si vijon:</p> <p>Viti akademik 2021-2022:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kuota të miratura, 8 - Studentë të regjistruar kursi parë, 9 - Studentë të diplomuar, 4 - Studentë mbetës, 2 <p>Mbajtja e këtyre statistikave bëhet për periudha më afatshkurtra në shërbim të programeve dhe cikleve të ndryshme të studimit. Sekretaritë mësimore funksionojnë në bazë të Rregullores së tyre, e cila është miratuar edhe në Senatin Akademik.</p> <p><i>(Evidencë, Takimi në Sekretarinë mësimore).</i> <i>Evidencë Nr. 52/1. Të dhëna nga sekretaria mbi Studentët e Masterit bazuar në Regjistri Themeltar, Regjistri i Arrietjeve Akademike, Regjistri i Lëshimit të Diplomave.</i> <i>Evidencë Nr.52. Rregullorja e Sekretarije mësimore FAB</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Deklarojmë se Sekretaria mësimore disponon gjithë informacionin për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Këto të dhëna disponohen në format letër (në regjistrat përkatës) si dhe në Sistemin "Pitagora", ku stafi akademik hedh të dhënat dhe ndjek ecurinë e studentëve përgjatë vitit akademik, po ashtu edhe vetë studentët mund të ndjekin ecurinë e tyre, si dhe të informohen për mungesat, vlerësimet, etj. Informatizimi i shërbimeve për administrimin e Studimeve dhe Kurrikulës, ka filluar zbatimin që nga viti 2013. Krijimi i arkivës dixhitale ka sjellë edhe një saktësim të të dhënave, lehtësim dhe shpejtësi në komunikim.</p> <p><i>(Evidencë RVB, Takimi në Sekretarinë mësimore)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njërive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe</p>	<p>Sipas Rregullores në Sektorin Mësimor, e cila përcakton se ky sektor kryen kontrollin periodik pranë gjithë njërive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. Rregullorja e Sektorit Mësimor është miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr 21, datë 07.10.2021, në Universitetin e Arteve. Gjatë takimit me këtë Sektor, GVJ u informua se</p>

saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	ky sektor kryen herë pas here kontrole në përfundim të vitit akademik, në sekretariatë mësimore duke vëzhguar nga afër regjistrat e arritjeve akademike (regjistri i notave) duke krahasuar një sistem të rastësishëm se si janë hedhur notat në këtë rregjistër nga stafi i sekretarisë. Sipas sekretarisë mësimore u informuam, që nuk është vërejtur asnjë problem serioz në keq hedhjen e notave apo edhe të ndryshimit të tyre. <i>Evidencë Nr.75. Rregullorja e funksionimit të Sektorit Mësimor.</i> <i>Evidencë: Takimi në Sekretarinë mësimore</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Gjatë takimeve në Institucion, GVJ u takua edhe me përgjegjësin e Departamentit të Pikturës, i cili bëri një pasqyrim në lidhje me mbarëvajtjen e këtij Departamenti ku u konfirmua që për çdo vit akademik realizohet një raport analitik, ku prezanton cilësinë e studentëve, rezultatet e arritura prej tyre, si dhe realizimin e objektivave të departamentit për këtë program studimi. Departamenti në bashkëpunim me zyrën e Alumnit ruajnë komunikime të shpeshta me të diplomuarit e tyre lidhur me ecurinë e tyre në tregun e punës dhe mbështetjen e tyre të mëtejshme nëpërmjet kualifikimit të vazhduar apo edhe paraqitjen e mundësive për punësim, si dhe me marrjen e mndimit të tyre në lidhje me vlerësimin e dijeve dhe aftësive që ato kanë marrë gjatë periudhës së studimeve në FAB. Propozimet e tyre për përmirësime në programin e studimit janë parë gjithnjë me vlerë dhe të kanë qënë gjithmonë të mirëpritura. <i>Evidencë Nr.15. Raporti vjetor i Departamentit të Pikturës</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se të dhënat për studentët që në rregjistrimin e tyre dhe deri në përfundim të studimeve janë të mirëmbajtur nga Sekretaria Mësimore e FAB.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	GVJ sipas takimeve në institucion ju komunikua se studentët përfaqësohen në të gjitha nivelet në UART, duke filluar që nga Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Këshilli studentor, etj. GVJ ju komunikua gjithashtu se edhe me miratimin e Statutit të ri të UART të MASR Nr 3937/5, datë 15.09.2021, me VSA Nr 15, datë 30.08.2021, studentët përfaqësohen në Senatin Akademik të UART prej 19 anëtarësh me 2 studentë, duke forcuar zërin e tyre në ngritjen e problemeve por edhe duke patur në konsideratë edhe zgjidhjen e tyre.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>Statusi i studentit fitohet me regjistrimin e tij në një nga njësitë kryesore të UART. Statusi humbet kur student merr diplomën ose certifikatën përkatëse, apo çregjistrohet nga UART.</p> <p><i>Evidencë Nr.2. Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015, kreu IX.</i> <i>Evidencë Nr.12. Rregullore Mësimore FAB, neni 56 pika a dhe b.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>GVJ ju komunikua se edhe studentët përfshihen në forma dhe mënyra të ndryshme në vlerësimin e procesit akademik. Sondazhet e bëra nga Sektori Mësimor mbledhin të dhëna për secilin lëndë, secilin pedagog dhe të gjithë studentët mund të japin mendimet e tyre lidhur me proceset. GVJ ju tha që për gjetjet e sondazheve i dorëzohet një raport Rektorit të UART si dhe me vendim të Senatit Akademik Nr 22, datë 07.10.2021 është miratuar Rregullorja e Komisionit të marrdhënieve me studentët. Objekti kryesor i ngritjes së këtij komisioni është sigurimi në një nivel cilësor i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe të bashkëpunimit të ngushtë me studentët, pedagogët përkatës si dhe njësitë e brendshme të ngritura në UART, duke garantuar dhe zhvilluar mbarrëdhëniet e bashkëpunimit midis organeve drejtuese të UART dhe të studentëve të tij. Misioni i këtij komisioni është bashkërendimi i punës së stafit akademik, stafit administrativ dhe e studentëve si dhe monitorimi i zbatimit të procedurave të aprovuara nga organet drejtuese për të gjithë procesin mësimor në aspektin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Një tjetër formë ishte dhe ajo e përfaqësimit me një anëtar grupi pune në grupet e punës të vlerësimit të brendshëm të akreditimeve të programeve apo akreditimit institucional. Edhe në hartimin e këtij raporti të vlerësimit të brendshëm, është përfshirë një student nga Programi i Studimit Master i Arteve në "Pikturë Monumentale dhe Mësuesi".</p> <p><i>Evidencë Nr.72 dhe 73. Sondazhet e bëra nga Sektori Mësimor dhe Raporti mbi gjetjet e sondazhit.</i> <i>Evidencë Nr.74. Vendimi i dekanatit Shkresës me Nr.27 prot., datë 04.03.2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Gjatë takimit me Sektorin mësimor, GVJ u informua se në Universitetin e Arteve, si një institucion me veprimtari specifike siç është fusha e artit dhe me një numër të kufizuar studentësh, njësia përgjegjëse që garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi është Sektori Mësimor. Ky sektor, organizon sondazhe nëpërmjet pyetësorve për të mbledhur të dhëna lidhur me mësimdhënien, programet e studimit, facilitetet, burimet materiale, logjistikën dhe shërbime të tjera. Gjetjet e këtij raporti i bëhen të ditura nëpërmjet një raporti Rektorit të UART.</p> <p><i>Evidencë Nr. 72. Sondazhet e bëra nga Sektori Mësimor</i> <i>Evidencë, Nr.73. Raporti mbi gjetjet e sondazhit</i></p>

<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ u informua se vlerësimi i studentëve kryhet nëpërmjet: provimit, niveli i aktivizimit në seminare/leksione, provime të prapambetura tek lëndët teorike etj. Në të gjitha format e organizimit të provimit, studenti merr vlerësimin përkatës nga komisioni i provimit të lëndës, jo më vonë se tre ditë pune nga data e dhënies së provimit. Në raste të jashtëzakonshme shtyerja e dhënies së rezultatit bëhet me vendim të Dekanit. Komisioni shpall rezultatet e vlerësimit, para plotësimit të dokumentacionit përkatës. Studentëve u njihet e drejta e ankimit. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kontestojë rezultatit e marrë. Komisioni është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjen e dokumentuar ose rregjistrimet (kur ka) të studentit më tezën e zgjidhur. Në rastet e kontestimit të rezultatit, në Komision duhet të marrë pjesë edhe Përgjegjësi i Departamentit, për të monitoruar transparencën e procesit. Në përfundim të këtij procesi rishikimi, komisioni merr vendimin përfundimtar, i cili është i formës së prerë. Përgjegjësi i Departamentit ndjek procedurën e përcaktuar në rregullore për trajtimin e ankimeve duke garantuar transparencë dhe barazi. Nga takimet me studentët GVJ u informua se nuk ka patur problematika të evidentuara në lidhje me procesin e vlerësimit të tyre nga ana e pedagogëve. <i>Evidencë Nr.12. "Rregullore Mësimore e FAB", Kreu V, neni 45, pika 12, 13, 14, 15, 16.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se FAB përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Po, sipas evidentimit nga GVJ, Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. GVJ gjatë vizitës në Institucion pati mundësinë që përveç Sektorit mësimor, Sekretarinë Mësimore, të informohet edhe për përfaqësuesin e sektorit të projekteve. Gjat takimit me këto sektorë, u informuam se Universiteti i Arteve ka ngritur njësi me qëllim informimin dhe shërbimin e studentëve siç janë: Sekretaria Mësimore dhe Sektorin Mësimor i cili në përbërje të tij ka edhe strukturën e "Informimit të studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni dhe Koordinatorin i Institucional. Këto zyra</p>

	<p>ndjekin ecurinë e studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar këshillim për çështje akademike, në shërbim të procesit mësimor, si dhe ato studentore. Sipas rregullores së sektorit mësimor, ky sektor ka si detyrë: Ndjekjen, gjurmimin dhe rritjen e marrëdhënieve të vazhdueshme me studentët aktualë dhe me studentët e diplomuar. Studentët e diplomuar të Universitetit të Arteve janë të gjithë artistë të mirëfilltë si dhe specialistë të lartë të fushës së mësuesisë sipas profilit në të cilin janë diplomuar. UART është pjesë e rëndësishme e projektit GRADUA, projekt i cili do të mbështesë Universitetet Shqiptare duke implementuar një model të integruar të kërkesës bazuar në bazën e të dhënave të të diplomuarve nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) mbledhjes së të dhënave për performancën e të diplomuarve; b) lehtësimin e bashkëpunimit midis institucioneve të arsimit të arsimit të lartë dhe biznesit; c) lehtësimin e vendosjes së të diplomuarve në tregun e punës, etj. <p><i>Evidencë Nr.75. Rregullore e Sekretarive FAB</i> <i>Evidencë Nr.75. Rregullore e Funkcionimit të Sektorit Mësimor</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Konfirmojmë që: Bazuar edhe sipas të dhënave në web faqen e FAB/UART dëshmohej se përveç Sekretarisë Mësimore dhe Sektorit Mësimor i cili në përbërje të tij ka edhe njësinë e Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni si dhe Koordinatorin i Institucional, përdoret me efikasitet të plotë faqja e web-it të UART si dhe së fundmi sistemi PITAGORA në koordinim të plotë me Rrjetin Akademik Shqipëtar. Në këtë sistem informohen studentët si për rezultatet e tyre ashtu edhe me gjithçka tjetër në lidhje me procesin mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Gjatë takimit me Sektorin Mësimor, GVJ u informua se ky Sektor, ka pjesë të tij edhe Informimin e Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni. Specialist i këtij Sektori është edhe Koordinatori Institucional, që mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Sektori mësimor një nga detyrat e tij ka edhe mbajtjen e marrëdhënieve të vazhdueshme me këshillat studentorë; drejtimin e procesit të këshillimit të studentëve; mbajtjen e komunikimit me tregun e punës; si dhe ofrimin e asistencës në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve në fushën e artit dhe kulturës. Po ashtu zyra ruan lidhje të ngushta me Këshillin Studentor dhe bashkëpunojnë për organizimin e aktiviteteve të ndryshme të propozuara prej studentëve. Gjithashtu, zyra bashkëbisedon me studentët e vitit të parë dhe u prezanton atyre: institucionin, programet, mundësitë e punësimit etj.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>Evidencë Nr.75. Rregullore e Funkzionimit të Sektorit Mësimor</i> <i>Evidencë Nr.29. Rregullore mësimore e ciklit të dytë të studimeve master në Universitetin e Arteve, Neni 40</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Gjatë takimit me Sektorit mësimor, GVJ u informua se në përbërje të Sektorit Mësimor, funksionon edhe Struktura e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni në UART. Kjo strukturë, mbante kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe ka krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Këto të dhëna ajo i siguron bazuar në komunikimet e vazhdueshme me ta, nëpërmjet adresave të e-mailit, të dhënave të kontaktit, adresave të rrjeteve sociale, etj. Çdo vit, struktura e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, harton plane dhe raporte vjetore në lidhje me gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar programin e studimit, dhe sipas kërkesës ua vë ato në dispozicion organeve përkatëse. <i>Evidencë Nr.75. Rregullore e Funkzionimit të Sektorit Mësimor</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se në UART funksionon mirë gjithçka që lidhet me studentët dhe me problemet apo edhe me specifikat e tyre si artistë të së nesërmes.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ ju komunikua se për vetë specifikën e programeve që ofrohen, në UART mënyra më e mirë e zhvillimit të orës së mësimi është zhvillimi i mësimi në auditor. Përgjatë vitit akademik 2019-2020 procesi mësimor dhe tërë veprimtaria akademike ishte kryer online në përshtatje me situatën e krijuar nga pandemia COVID -19. Organizimi i mësimi online ishte një metodë dhe një eksperiencë e re në zhvillimin e procesit të mësimdhënies jo vetëm nga studentët por edhe nga stafi akademik i UART. Gjatë kësaj kohe ishte ngritur dhe ishte vënë në funksionim

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>sistemi Microsoft Teams i ngritur nga Rektorati dhe sektori i TI. Për këtë arsye Sektori i TI vendosi në dispozicion manualin e përdorimit të këtij sistemi si për pedagogët ashtu dhe për studentët. GVJ ju komunikua se mbështetur në të gjithë format e komunikimit, edhe studentët u përgatitën që provimet t'i jepnin online, me mënyra alternative, individualish apo me grupe të vogla të organizuara në bashkëpunim dhe nën drejtimin e stafit akademik.</p> <p><i>Evidencë Nr.51.1. Manuali i përdorimit të sistemit të Microsoft Teams</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>GVJ gjatë takimit ju komunikua se një nga mekanizmat më të përdorur për monitorimin dhe vlerësimin periodik të ecurisë së programeve të studimit dhe aftësive mësimdhënëse të personelit akademik, janë sondazhet dhe pyetësorët të zhvilluara me studentët dhe pedagogët nga Sektori Mësimor apo edhe nga vetë departamentet. Ishte e qartë që strukturat kryesore për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në UART janë njësitë bazë. Këto Njësi apo Departamente mbështeten në strukturat përkatëse si Sektori mësimor, i Kurrikulave dhe Informimit të studentëve si dhe Sekretariatë mësimore pranë secilit Fakultet, duke koordinuar punën për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Institucioni ndjek politika mbështetëse për kualifikimin e personelit akademik për të kontribuar në këtë mënyrë në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Kjo politikë, konsiston edhe në mbështetjen e mobilitetit të personelit akademik, me qëllim përfitim të eksperiencave dhe metodologjive të reja të mësimdhënies. Një aspekt i rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies është trajnimi i stafit akademik në fushën e cilësisë së edukimit.</p> <p><i>Evidencë Nr.78. Pyetësori për stafin akademik dhe raporti</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>GVJ ju komunikua se për vetë specifikën e procesit mësimor, ku studiot dhe atelietë janë laboratorë të mirëfilltë kërkimorë, procesi mësimor parashikon përfshirjen e studentit në çdo hap, nisur që nga paraqitja e programit të lëndës, hapat e realizimit të tij, te informimi për mënyrën e vlerësimit e deri te paraqitja e provimeve para publikut. Studentët në UART kanë të gjithë vëmendjen e duhur si nga personeli akademik ashtu edhe nga ai administrativ. Ashtu siç jemi shprehur edhe në kriteret e mësipërme, GVJ deklaroi se studentët kanë të drejtë edhe të ankimit për vlerësimet e tyre, fillimisht në departamentet përkatëse, e më pas në Dekanat apo Rektorat.</p> <p><i>Evidencë Nr.9. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.145, Neni 123, pika 1, 2. Neni 126</i></p> <p><i>Evidencë Nr.47. Pyetësori i studentëve dhe raporti</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ shprehet se gjatë takimeve në Institucion, ju bë e qartë se rezultatet e monitorimit të cilësisë së programeve të studimit, të metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve, nëpërmjet pyetësorëve, bëhen publike nëpërmjet afishimit të tyre fizikisht në vende të dukshme në mjediset e brendshme të FAB, takimeve informuese me pedagogët dhe studentët, kontakteve me Këshillin Studentor të UART si dhe analizave</p>

	<p>vjetore të departamenteve. Ato publikohen periodikisht në web faqen të UART.</p> <p><i>Evidencë Nr.79. Rezultatet e pyetësorit për studentët dhe pedagogët.</i> <i>Evidencë Nr.24. Raporti vjetor i Departamentit të Pikturës</i></p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies nëpërmjet Nxjerrjes së rezultateve të monitorimit të cilësisë së programeve të studimit, të metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve nëpërmjet pyetësorëve, evidenton shembuj të praktikave të mira dhe brenda kufijve të etikës, duke nxitur stafin akademik për përmirësim të proceseve të mësimdhënies, të programeve të studimit dhe të vlerësimit të dijeve sipas kërkesave bashkëkohore.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>Standardi VI.1: është i përmbushur</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

<p>Standardi VI.2</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Struktura kryesore përgjegjëse për sigurimin e brendshëm është Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC). Organizimi dhe funksionet e komisionit janë të parashikuara në Statutin e UART. Sipas deklarimeve të tyre, Komisioni bazohet në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Kodin e Cilësisë të Arsimit të Lartë, Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit, Statutin e UART. Ky Komision është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion.</p> <p><i>Evidencë Nr.9. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.145, datë 10.03.2021, Për dhënien e Statusit të vecantë UA si institucioni i vetëm public i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”,</i> <i>Evidencë Nr.29. Rregullorja mësimore e ciklit të dytë të studimit në UART</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të</p>	<p>GVJ ju komunikua se duke qënë se Sigurimi i Cilësisë është një proces i vazhdueshëm i monitorimit, vlerësimit, garantimit, ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së veprimtarisë të të gjithë Universitetit të Arteve në përgjithësi por edhe të tre Fakulteteve, pjesë kryesore e këtij Universiteti, është menduar që në përbërjen e këtij Komisioni të jenë: Zv Rektorit për anën mësimore, Zv Rektori për projektet artistike dhe</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

56

<p>cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>shkencore dhe një Përgjegjës nga secili Departament si dhe i gjithë Sektori Mësimor&Kurikulës. Pjesë e këtij Komisioni për FAB ishte Përgjegjësi i Departamentit të Pikturës, i cili shtjelloi gjerësisht gjithë specifikën dhe mënyrën e funksionimit të këtij Komisioni. Ndër politikat dhe rregulloret që standardizojnë funksionimin dhe detyrat apo angazhimin e Sigurimit e Brendshëm të Cilësisë përmenden: Organizimi i Brendshëm i Cilësisë; Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve dhe Politikat dhe procedurat e vetëvlerësimit. Dokumenti kryesor për mbarvajtjen e punës së njësisë është Rregullorja e funksionimit të Komisioni <i>Ad Hoc</i> për Sigurimin e Cilësisë, e cila është e miratuar me Vendim Senati Nr.24, datë 07.10.2021. Sigurimi i cilësisë duhet shoqëruar me kërkesa gjithnjë në rritje për realizimin e të cilave nga secili punonjës të kërkohej maksimumi i performancës dhe kualifikimi i vazhdueshëm.</p> <p><i>Evidencë Nr.9. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.145.</i> <i>Evidencë Nr.29. Rregullorja mësimore e ciklit të dytë të studimeve Master UART, kreu V, neni 18, 22, Kreu IX, neni 37.</i> <i>Evidencë Nr.76. Rregullorja e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë</i> <i>Evidencë Nr.48. Raporti vjetor i punës artistike mësimore-shkencore i stafit akademik të UART për vitin akademik 2020-2021.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në nivel institucioni dhe programesh studimi organizohet në mënyrë periodike nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), kurse Sigurimi i Brendshëm i cilësisë garantohet nga vetë institucioni dhe menaxhohet nga Komisioni <i>Ad Hoc</i>. UART i është akorduar riakreditimi institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.17, dt. 24.03.2022 duke e vlerësuar pozitivisht me vlerësimin maksimal, me kohëzgjatje 6 vite akademike. Raportet e vetëvlerësimit të brendshëm publikohen në ëeb faqe të UART. Ndërsa programi i studimit Master i Arteve në “Pikturë Monumentale dhe Mësuesi”, ashtu si edhe të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë që ofrohen në FAB por edhe në UART, po i nënshtrohen akreditimit për herë të parë të tyre.</p> <p><i>Evidencë Nr.9. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të vecantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm public i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”, Kreu X, neni 135, 136</i> <i>Evidencë Nr.29. Rregullorja mësimore e ciklit të dytë të studimeve Master UART, kreu V, neni 18, 22, Kreu IX, neni 37.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara</p>	<p>Institucioni mjaftueshëm përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Praktika që ndiqet për ndryshime dhe përmirësime të programeve të studimit, në funksion të rritjes së cilësisë, është e përcaktuar dhe në përputhje me</p>

dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Rregulloret për funksionimin e Fakultetit dhe Rregulloret Mësimore të dy cikleve të studimit me kohë të plotë Bachelor dhe Master. GVJ ju komunikua se një nga treguesit më të matshëm për cilësinë e programeve të studimit dhe mësimdhënies në Universitetin e Arteve, është punësimi i studentëve të tij si brenda dhe jashtë vendit, në institucione prestigjioze të fushës së arteve që përbën edhe një nga pikat e forta të diplomuarve në këtë program studimi. <i>Evidencë Nr.29. Rregullorja mësimore e ciklit të dytë të studimeve Master e UART, Kreu II, neni 7.</i> <i>Evidencë Nr.33. Rregullore e programit të studimit Master i arteve në Pikturë Monumentale dhe Mësuesi</i>		
Konkluzione	Standardi VI.2 është i përbushur, UART zbaton mjaftueshëm politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	E konfirmojmë që Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë. Mbikëqyrja e herëpashershme e programit të studimit Master i Arteve në "Pikturë Monumentale dhe Mësuesi" bazohet në vjeljen e informacionit nëpërmjet pyetësorëve që plotësohen në fund të çdo semestri e që i kushtohen vlerësimit të programit të studimit dhe personelit akademik. Vlerësimi i programeve të studimit të ofruara nga FAB kryhet duke analizuar përputhshmërinë me objektivat dhe strategjinë e zhvillimit, treguesit e matshëm, zhvillimin e programeve të studimit dhe vlerësimin, të dhëna për zhvillimin e teknologjisë në vend lidhur me programet e studimit si dhe duke formuluar gjetje dhe rekomandime. Gjetjet dhe përgjigjet në këto pyetësor shqyrtohen në Departament duke shqyrtuar problematikat e hasura dhe ecurinë e mësimdhënies për çdo pedagog. <i>(Evidencë: Pyetësi për studentët dhe stafin akademik)</i> <i>Evidencë 12.2. Raporti vjetor i punës artistike mësimore-shkencore</i> <i>Evidencë Nr.24 Raporti vjetor i Departamentit të Pikturës</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e	Referuar takimeve në institucion, një formë e vlerësimit sidomos për stafin akademik është edhe vlerësimi i tij prej strukturave përgjegjëse e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>prishme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>drejtuese në fund të çdo viti akademik. Njësitë kryesore pasi marrin në dorëzim raportet, i analizojnë konkluzionet me stafet e tyre akademike, ku ftohen dhe përfaqësues të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të dhënë komentet përkatëse, dhe ndërmarrin veprime me hapa konkretë për përmirësimin e situatës. Në formatin e vetëvlerësimit të stafit akademik, strukturat menaxhuese kur e shohin të arsyeshme kanë mundësi të bëjnë komente dhe sugjerime për secilin pjestar të stafit. Në disa raste, për të adresuar problematikat e konstatuara, janë zhvilluar trajnime si për shembull për kuptimin e kurrikulës nga stafi i ri, përdorimin e teknikave të mësimdhënies etj.</p> <p><i>(Evidencë RVB; Takime në institucion)</i> <i>Evidencë Nr.24 Raporti vjetor i Departamentit të Pikturës</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ u informua se metodat e drejtpërdrejta të përdorura në procesin e vlerësimit kanë përfshirë, takimet e autoriteteve drejtuese me studentët, takimet e autoriteteve drejtuese me qeverinë studentore, takimet e përgjegjësve të departamenteve me studentët e programeve të studimit, takimet me studentët ALUMI, vëzhgime në auditor për metodat dhe pedagogjinë e mësimdhënies së stafit akademik apo angazhimin e studentëve, vlerësimet e testeve dhe ecuria gjatë një viti akademik e studentëve programit, analizë e problematikave lidhur me frekuentimin dhe kalueshmërinë etj. GVJ pati rastin të konfirmojë një pjesë të këtyre elementëve gjatë takimeve në institucion me stafin akademik, studentët, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm dhe Komisionin <i>Ad Hoc</i> të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (SBC).</p> <p><i>Evidencë Nr.24. Raportet vjetore të Departamentit të Pikturës Platforma ALUMNI (http://uart.edu.al/index.php?id=845)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që</p>	<p>Referuar RVB dhe takimeve në institucion, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit institucioni përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si pyetësorë, anketime, raporte vjetore, raporte vlerësimi programi, raporte vlerësimi prej strukturave drejtuese, vetvlerësim të stafit akademik, pyetësorët me studentët ALUMNI, vlerësimet e studentëve ALUMNI, gjurmimin e studentëve dhe mbledhjen e të dhënave për punësimin (për punësimin në profil ose jashtë profili etj), takimet me ALUMNI në institucion, gjatë trajnimeve ose në sipërmarrjet ku ata punojnë. Sektori Mësimor, Alumni dhe Karrierës, realizon studime periodike të punësimit të studentëve dhe zotëron një databazë të studentëve të punësuar.</p> <p>Evidencat e paraqitura dëshmojnë për përdorimin e metodave dhe instrumenteve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të vlerësimit në institucion.</p> <p><i>Evidencë: Pyetësori i studentëve dhe stafin akademik</i></p>



59



shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	<i>Evidencë Nr.54. Fletëpalosje me kalendarin e aktiviteteve të ndryshme të realizuara nga pedagogë dhe student të FAB.</i>		
Konkluzione	GVJ konstaton se UART monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X



Standardi VI.4
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ ju komunikua se në komisionin Ad Hoc, për shkak të rëndësisë dhe funksionit që kryen ky komision janë të përfshirë dy zv/rektorët e UART. Komisioni <i>Ad Hoc</i> për Sigurimin e Cilësisë menaxhon sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucion, aktiviteti i së cilës synon përfshirjen e numrit sa më të madh aktorësh të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Në varësi edhe të fushës së ekspertizës, aktorët e brendshëm angazhohen më tepër në drejtim të përmirësimit të cilësisë së mësidhënies në gjithë elementët përbërës të saj, ndërsa aktorët e jashtëm kontribuojnë në drejtim të përshtatjes së programit të studimit me kërkesat e tregut të punës. I gjithë aktiviteti i këtij Komisioni bazohet në Statutin e UART, bazën Rregullative të UART dhe në mënyrë të veçantë në Manualin e Sigurimit të cilësisë. (Evidencë <i>Takime në institucion; Marrëveshjet në kuadër të Erasmus+</i>)
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Referuar RVB, përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë dhe strukturat e angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë janë të përcaktuara në dokumentet bazë si Organizimi i Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Procedurat për mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, Politikat dhe procedurat e vetëvlerësimit, Manualin e Sigurimit të cilësisë. Komisioni i Sigurimit të Cilësisë dhe Sektori Mësimor dhe i Kurrikulës, anëtarët e këtij komisioni dhe këtij sektori, kanë përgjegjësi dhe detyra konkrete dhe të ndryshme, në përshtatje edhe me rolet që ata kanë në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse	Vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë së programit të studimit Master i Arteve në "Pikturë Monumentale dhe Mësuesi" është garantuar përmes një procesi gjithëpërfshirës. Për të mundësuar një vlerësim real të programit të studimit me qëllim jo vetëm përmbushjen e detyrimit ligjor, por edhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit, GVB në takimin

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	e përbashkët konstatuan se kanë patur një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj. (Evidencë RVB; Takime me GVB) Evidencë Nr.24. Raporti vjetor i Departamentit të Pikturës						
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e studimit Master i Arteve në "Pikturë Monumentale dhe Mësuesi", në veprimtarinë e saj, Komisioni i Sigurimit të Cilësisë mbështetet nga Universiteti i Arteve në përgjithësi si dhe nga Fakulteti i Arteve të Bukura dhe Departamenti i Pikturës në veçanti. Në punën e saj ky Komisioni zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie. GVJ nuk gjeti praktika të prekjes së integritetit apo ankimit në lidhje me procesin në përgjithësi si dhe anketimet e kryera në veçanti. Institucioni nuk kishte asnjë rast të ngritur ose të regjistruar të diskriminimit apo pabarazisë së ushtruar ndaj personelit ose studentëve. Evidencë Nr.80.. Kodi i Etikës i UART						
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	FAB ka pasur dhe ka një bashkëpunim të vazhdueshëm me artistë të njohur të fushave të ndryshme të artit si brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet angazhimit të tyre në procesin e mësimdhënies si pedagogë me kohë të pjesshme. Nëpërmjet zhvillimit të shkëmbimeve të drejtpërdrejta me kurator, piktor, skulptor, pedagogë të vendit apo të huaj nga rajoni apo më gjerë, vazhdimisht merret ekspertizë e vlefshme lidhur me programet e mësimin, cilësisë dhe përafrimin e tyre me programet e IAL simotra dhe cilësinë e mësimdhënies, nëpërmjet ballafaqimit të nivelit të përgatitjes së studentëve në këto masterclass-e. Ekspertiza dhe sugjerimet e tyre vijnë nëpërmjet tryezave të rrumbullakëta, aktiviteteve të përbashkëta, mbledhjeve etj. Në këto rast është konsideruar me prioritet opinionin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për të vlerësuar dhe pasqyruar elementë që lidhen me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.						
Konkluzione	Standardi VI.4 është i përbushur plotësisht.						
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për	GVJ sipas verifikimit në web faqen e UART e konfirmon që politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (SBC) për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Shih: (www.uart.edu.al)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ u informua që UART publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. Referuar RVB parimet mbi të cilat ndërtohet Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë janë të përcaktuara në Rregulloren e Sektorit Mësimor dhe i Kurrikulës si dhe në Rregulloren e Komisionit të Sigurimit të Cilësisë. Janë këto parime që sigurojnë garantimin e transparencës me qëllim informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerë për performancën e njësive të tij, programeve, kurrikulave, shërbimeve etj. Të gjithë raportet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit gjendeshin të publikuara në ëeb faqen e UART.</p> <p><i>Evidencë Nr.75. Rregullore e Funkcionimit të Sektorit Mësimor.</i> <i>Evidencë Nr.9. Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.145</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Në UART, FAB, raportet vjetore, sondazhet apo pyetësorët shoqërohen me rezultate të vlerësimit dhe me një plan masash për të adresuar dhe zgjidhur problematikat e vrejtura me qëllimin përmirësimin e dobësive të evidentuara. Një rol të posaçëm luan dhe Sektori Mësimor dhe i Kurrikulës, si dhe Sektori i TI, duke përgatitur raporte me përmbledhje të dhënash lidhur me përgjigjet e pyetësorëve.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Procesi i vlerësimit dhe sigurimit të efektivitetit dhe impaktit të veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit është një proces kompleks i cili kërkon angazhimet e të gjithë strukturave të institucionit. Në nivel institucioni kjo, sipas RVB, realizohet përmes strategjive, matshmërisë së realizimit të objektivave, studimeve të tregut, raporteve, analizave, vlerësimeve të brendshme dhe të jashtme, pyetësorëve dhe anketimeve, angazhimit të ekspertëve dhe të gjitha instrumenteve të tjera akademike dhe administrative. Megjithatë, GVJ është i mendimit që, një proces i monitoruar në mënyrë më të përqëndruar, do të kishte një impakt më të spikatur në përmirësimin e sigurimit të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Komisioni i Sigurimit të Cilësisë dhe Sektori Mësimor dhe i Kurrikulës, organizojnë veprimtari periodike me personelin dhe me studentët për informimin, ndërgjegjësimin dhe trajnimin e tyre mbi sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit nëpërmjet pyetësorëve të zhvilluar për këtë qëllim.</p> <p>GVJ ju konfirmua nga disa drejtime se një sërë takimesh janë realizuar me stafin akademik të brendshëm dhe të jashtëm në kuadër të riakreditimit institucional të UART, proces i cili u mbyll me një vlerësim maksimal. Një sërë takimesh janë realizuar edhe nga Komisioni <i>Ad Hoc</i> i të gjithë procesit të akreditimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë, program i cili është edhe MA në Pikturë Monumentale dhe Mësuesie. Vetë përbërja</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	e këtij Komisioni tregon për rëndësinë që ka sigurimi i Cilësisë në këtë Institucion.			
Konkluzione	GVJ konstaton se Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe efektive, dhe synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Përfundime të vlerësimit të jashtëm për programin e studimit të ciklit të dytë, Master i Arteve në “Pikturë Monumentale dhe Mësuesi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Unversiteti i Arteve.

Pikat e forta

1. Programi Master i Arteve në Pikturë Monumentale dhe Mësuesi është inicuar nga UART, FAB, në frymën e hapësirave që ju ofron ligji dhe në respekt të formatit ligjor të programit.
2. Programi derivon nga një studim i detajuar i tregut. Misioni dhe vizioni i programit pritet të përmbush nevojat e Arsimit parauniversitar për mësues në disiplinat e Arteve, një nga vakumet e identifikuara në sistem prej më shumë se një dekade. Diplomimi i Mësuesve në disiplinat e Artit do ti shtojë vlerat dijes shkollore dhe sistemit të edukimit.
3. Kurrikula e programit në fjalë është e sofistikuar. Kurrikula, rezulton mjaftueshëm e balancuar referuar raporteve ndërdisiplinore...disiplinave me thekse në shkencat e edukimit dhe mësimdhënies dhe spikat në disiplinat karakterizuese.
4. Syllabuset e disiplinave janë hartuar referuar skemës së kërkuar nga ligji për arsimin e lartë, shkruar me një gjuhë të sofistikuar dhe të përkthyer e përdhryer në ECTS referuar sistemit të Bolonjës. Kjo e bën Programin të matshëm dhe të transferueshëm.
5. Mjediset fizike ku përmbushet programi janë mjaftueshëm të shfrytëzuara, Student për /metër katror.
6. Stafi akademik, {i brendshëm dhe i jashtëm} rezulton me Tituj dhe Grada konform kërkesave të ligjit për arsimin e lartë. Stafi reflekton dije dhe përkushtim për Diplomimin e Mësuesve në Arte dhe në mësuesi.
7. Biblioteka paraqitet institucion serioz. Literaturë të pasur dhe të organizuar kryesisht në disiplinat e artit të Pikturës, por...Shkencat e edukimit, metodologjia e mësimdhënies, psikologjia dhe Didaktika pritet të jenë në proces të pasurimit dhe sistemimit të tyre.


Pikat e dobëta

1. Programi ka numër të vogël të studentëve të rregjistruar.
2. Praktikat profesionale ku aplikohet kopetenca mësimdhënëse, nuk na rezultojnë aq të mirë-organizuara, sa praktikat mësimore që të zhvillojnë në fushën e dijes karakterizuese, pikturës. **(Stadardi III.6/kriteri 3)**
3. Mungonte lista e mentorëve që do të udheheqin praktikat në Sistemin parauniversitar, pra mësuesit prites në shkollat ku do të përmbushet praktika profesionale. **(Stadardi III.6/kriteri 3)**
4. Nuk kishte një plan afatgjatë për të zyrtarizuar listë mentorësh dhe për të investuar në paketa trajnimi në formimin specific të një mentori. **(Stadardi III.6/kriteri 3)**
5. Biblioteka kishte numër të kufizuar të literaturës në fushat e shkencave të edukimit, gjë që duhet balancuar me literaturë të pasur që kishin disiplinat e arteve respektive. Nuk evidentuam një buxhet për pasurimin e bibliotekes për tituj në fushën e shkencave të edukimit. **(Stadardi IV.3/kriteri 4)**
6. Marrëveshjet për praktikat profesionale duhet dhe mund të jenë më të specifikuar dhe me detyrime reciproke nga dy institucionet {shkollat pritëse dhe FAB} **(Stadardi III.6/kriteri 3)**



Rekomandimet

1. Programi master në Arte "Pikturë Monumentale dhe Mësuesi" është i pari i këtij lloji në sistemin tonë universitar. Ky program do të përmbushet nën ombredhën e UART, institucioni që ka prodhuar historinë e artit në vendin tonë. Në rrafshin profesional ky program është i garantuar, por, pritet dije dhe seriozitet po aq, dhe në fushën e shkencave të edukimit. Kjo është sfida që ky program të ndricojë programet e tjera që pritet të celen në IAL jo publike si, Marin Barleti dhe Luigj Gurakuqi.
2. UART, dhe FAB, lipset të jenë më strategjike në politikat e tyre për të "ftuar" studentë të rinj që diplomohen si mësues me fokus dijen në arte.
3. Sygjerojmë që të rishihen raportet brenda modulit {A} {i referohemi faktit që dhe nga Grupi i ekspertëve RVB, është pranuar që do të sygjerojnë stafit të bëjnë ndryshime në orët dhe temat brenda bllokut {A}. Të lihet brenda mundësisë pak më shumë hapsirë dijeve nga fusha e shkencave të edukimit, deri në 3 ETCS dhe të quajmë, ... "Etika dhe Komunikimi" do të ishte e sygjyeruar nga ne, dhe jo Kodi Etik" Kjo lihet në dorë te Stafit.





**Conclusions of the external evaluation for the second cycle study program,
Master of Arts in "Monumental Painting and the Teacher" offered by the
Institution of Higher Education University of the Arts.**

Strengths and affirmations

1. The study program "Master in Monumental Painting and Teaching" was initiated by UART, FAB, in the form of the spaces in accordance by the law and by respecting the legal format of the program.
2. The study program derives from a detailed market labor study and its mission and vision is expected to meet the needs of pre-university education for teachers in the fields of art, one of the vacuums identified in the system for more than a decade. The graduation of teachers in the disciplines of art will add values to school knowledge and the education system.
3. The curriculum of the study program is sophisticated and sufficiently balanced with references to interdisciplinary reports...disciplines with emphasis in the sciences of education, teaching and with highlights in the characterizing disciplines.
4. The syllabi of the disciplines are drawn up referring to the scheme required by the law on higher education, written in a sophisticated language and translated into ECTS referring to the Bologna system. This makes the study program measurable and transferable.
5. The physical environments where the program is carried out are sufficiently utilized, in the standard ssm (student per square meter).
6. The academic staff, {internal and external} have affiliations Titles and Degrees in accordance with the requirements of the higher education law. The staff reflects knowledge and commitment to the Graduation of Teachers in the field of arts and teaching.
7. The library is presented as a serious institution. Rich and organized literature mainly in the disciplines of painting etc., but books from the field of educational sciences, teaching methodology, psychology and didactics are expected to be in the process of enriching the area.


Weakness

1. The program has a small number of joined students.
2. The professional practices where the teaching competence is applied, are not as well-organized as the teaching practices that are developed in the field of characterizing knowledge, of painting. **(Standard III.6/criterion 3)**
3. The list of mentors who will guide the internships in the pre-university system, i.e. the host professors in the schools where the professional internship will be completed, is missing. **(Standard III.6/criterion 3)**
4. There was no long-term plan to formalize a list of mentors and to invest in training packages in the specific formation of a mentor. **(Standard III.6/criterion 3)**
5. The library has a limited number of literatures in the fields of educational sciences, something that should be balanced with the rich literature that the disciplines of the respective arts had. We did not record a budget for enriching the library for books in the field of educational sciences. **(Standard IV.3/criterion 4)**
6. Agreements for professional practices should and can be more specified and with mutual obligations from the two institutions {host schools and FAB} **(Standard III.6/criterion 3)**



Recommendations

- a. The study program "Master in Monumental Painting and Teaching" is the first of their kind in our university system. This program will be carried out under UART, the institution that produced the history of art in our country. On the professional level, this program is guaranteed, but knowledge and seriousness are expected just as much in the field of educational sciences. This is the challenge for this program to illuminate other programs that are expected to be launched in non-public HEIs such as Marin Barleti and public University Luigj Gurakuqi.
- b. UART, and FAB, need to be more strategic in their policies to "invite" young students to graduate as teachers with an emphasis on arts.
- c. We suggest that the reports within the {A} module should be reviewed, we refer to the fact that the RVB group have agreed that they will suggest the staff to make changes to the hours and topics within the {A} block. Within the possibility there should be a little more space for knowledge from the field of educational sciences, up to 3 ETCS and to call it, ..."Ethics and Communication" would be suggested by us, and not the Code of Ethics but " This is left in the conscience of the academic Staff"



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesësisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X